



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
Ministarstva Obrazovanja Nauke i Tehnologije
Ministry of Education Science & Technology

IK INSTITUTI
PEDAGOGJIK
I KOSOVËS

UDHËZUES PËR VLERËSIMIN E **BRENDSHËM TË SHKOLLËS** (FUSHAT E CILËSISË –KRITERET-TREGUESIT)



**Arsim
cilësor**

Prishtinë, 2016



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE, NAUKU I TEHNOLOGIJU
MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE AND TECHNOLOGY



UDHËZUES PËR VLERËSIMIN E BRENDSHËM TË SHKOLLËS

(FUSHAT E CILËSISË –KRITERET-TREGUESIT)

Prishtinë, 2016

Botues

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Për botuesin

Labëri Luzha

PËRGATITUR NGA

Spektori për Planifikim Mësimor në Institutin Pedagogjik të Kosovës

KONTRIBUES

Xhavit Rexha

Lindita Boshtrakaj

Selim Mehmeti

Hajrije Devetaku-Gojani

Osman Buleshkaj

Trajnerë në fushën e vlerësimit të performancës së shkollës

Shkollat e para të përfshira në programin për vetëvlerësim të performancës së shkollës

Redaktori gjuhësor

Bedri Zyberaj

Radhitja

Skender Mekolli

Ballina

Gëzim Duzha

Shtypshkronja

“Blendi”

Dhjetor, 2016

Botimi i parë

PËRMBAJTJA

Shkurtesat	5
1. Hyrje	7
1.1. Qëllimi i udhëzuesit.....	7
1.2. Parimet kryesore të procesit të vetëvlerësimit	7
1.3. Funkcionet e udhëzuesit	8
1.4. Përdorimi i udhëzuesit	8
1.5. Përmbajtja dhe struktura e udhëzuesit.....	8
2.Konceptet kryesore:	9
2.1. Vetëvlerësimi	9
2.2. Vlerësimi i jashtëm.....	9
2.3. Plani zhvillimor i shkollës	9
2.4. Plani vjetor i veprimit.....	10
2.5. Fushat e cilësisë – aspekti vertikal:	10
2.6. Kriteret e cilësisë– shtrirja e vlerësimit:.....	10
2.7. Treguesit e performancës – thellësia:.....	11
3. Procesi i vetëvlerësimit në shkollë	13
3.1 Koha e zbatimit të vetëvlerësimit dhe planifikimit zhvillimor të shkollës	13
3.2 Hapat kryesorë të procesit të vetëvlerësimit	14
Faza përgatitore:.....	14
Hapi 1: Identifikimi i burimit të të dhënave	14
Hapi 2: Përgatitja e instrumenteve të vlerësimit	16
Hapi 3: Mbledhja e të dhënave.....	19
Hapi 4: Analiza e të dhënave të mbledhura	19
Hapi 5: Përfundimet (Vlerësimi i cilësisë)	20
Hapi 6: Raporti përmbledhës i vetëvlerësimit (RVV):.....	24
3.3. Shfrytëzimi i gjetjeve të vetëvlerësimit	24
Shtojca	26
Shtojca 1: Korniza e kriterëve të cilësisë së performancës së shkollës	27
Shtojca 2: Treguesit për vlerësimin e performancës, pyetjet e orientuese dhe burimet e mundshme të të dhënave.....	28
Shtojca 3: Tabela për identifikimin e burimeve dhe instrumenteve	55
Shtojca 4: Tabela për sistemimin e instrumenteve –	93

Shtojca 5: Shkallët për përcaktimin e trendit të performancës së shkollës	94
Shtojca 6: Shkalla e cilësisë së performancës së shkollës	95
Shtojca 7: Formulari i vlerësimit të performancës së shkollës	96
Shtojca 8: Struktura e përmbajtjes së raportit përmbledhës të vetëvlerësimit	130
Shtojca 9: Mostrat e instrumenteve për mbledhjen e të dhënave	131
Shtojca 9.1 Mostër e listës kontrolluese	132
Shtojca 9.2-A: Mostër e pyetësorit për nxënësit	135
Shtojca 9.2-B Mostër e pyetësorit për prindërit	138
Shtojca 9.2-C Mostër e pyetësorit për prindërit	142
Shtojca 9.2-D Mostër e pyetësorit për nxënës.....	144
Shtojca 9.3-A: Mostër e diskutimit në grup të fokusit	146
Shtojca 9.3-B: Udhëzues për diskutim në Grup fokusi në shkollë	148
Shtojca 9.5-B: Mostër e fletës për reflektim	157
Shtojca 10: Plani i vjetor i veprimit	159
BIBLOGRAFIA.....	164

Shkurtesat

AP	Aktive/ departamente profesionale
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
IPK	Instituti Pedagogjik i Kosovës
KB	Kurrikula Bërthamë
KC	Koordinatori i cilësisë
KDSH	Këshilli Drejtues i Shkollës
KK	Korniza Kurrikulare
KSNA	Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit (UNESKO)
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
PBKV	Cikli : Planifiko - Bej - Kontrolllo - Vepro
RVV	Raporti përmbledhës i vetëvlerësimit
PVV	Plani vjetor i veprimit
PZhPM	Plani i zhvillimit profesional të mësimitdhënësve
PZhSh	Plani zhvillimor i shkollës
SC	Sigurimi i cilësisë
SMIA	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim
UA	Udhëzim Administrativ
ZHPM	Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve

1. Hyrje

Udhëzuesi për vlerësimin e brendshëm të performancës së shkollës shërben për t'i mbështetur ekipet e shkollës dhe të gjithë faktorët e tjerë të interesit për shkollën që ta bëjnë vlerësimin e brendshëm - vetëvlerësimin e shkollës. Në këtë udhëzues paraqiten fushat e cilësisë, kriteret e cilësisë, treguesit e performancës së shkollës të shoqëruar me pyetje orientuese, përshkruhet procesi i vetëvlerësimit në të gjitha fazat e tij, ofrohen modelet e instrumenteve për mbledhjen e të dhënave, dhe ofrohen orientime për shfrytëzimin e gjetjeve të vetëvlerësimit. Ky udhëzues promovon një qasje përfshirëse ndaj të gjithë faktorëve mësimorë në shkollë dhe jashtë saj në drejtim të realizimit të misionit të përbashkët të shkollës. Rrjedhimisht, ai sugjeron intensifikim të komunikimit në mes të menaxhmentit me mësimdhënësit e nxënësit në një rën anë, dhe me prindërit e me komunitetin, në anën tjetër. Përfshirja më e madhe në fazën e vlerësimit do të rezultojë me rritjen e përfshirjes në implementim të masave të përbashkëta për përmirësim dhe, përfundimisht, e shton përgjegjësinë dhe llogaridhënien e të gjithë faktorëve të procesit mësimor.

1.1 Qëllimi i udhëzuesit

Mbështetja e ekipeve të shkollës dhe e komunitetit të shkollës për ta bërë vlerësimin e brendshëm dhe vetëvlerësimin e shkollës, si dhe mbështetja për ta zhvilluar shkollën në funksion të pritshmërisë së përcaktuar në Kornizën për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës, është qëllimi i këtij udhëzuesi.

1.2 Parimet kryesore të procesit të vetëvlerësimit

Pjesëmarrja – të gjithë kanë të drejtë dhe detyrë, sipas përgjegjësiwe personale dhe profesionale, të marrin pjesë në krijimin e një pasqyre sa më të saktë për gjendjen dhe trendet zhvillimore në shkollë; njëkohësisht, të gjithë do të jenë pjesë e planifikimit dhe e zbatimit të masave përmirësuese në shkollë, në pajtim me gjetjet e vetëvlerësimit;

Transparenca – të gjithë anëtarët e personelit, nxënësit dhe prindërit do të jenë të informuar hollësisht për procedurën e vlerësimit të brendshëm dhe do të jenë pjesë aktive e implementimit të tij. Njëkohësisht, varësisht nga roli, të gjithë faktorët do të informohen edhe për rezultatet e vlerësimit dhe masat për përmirësimin e performancës.

Objektiviteti – procesi i vlerësimit është organizuar në atë mënyrë që të sigurojë një pasqyrë reale e të paanshme të gjendjes lidhur me performancën e shkollës në tërësi dhe të faktorëve individualë, në veçanti.

Saktësia – të dhënat dhe dëshmitë e mbledhura do të jenë të sakta, të matshme dhe të dokumentuara në mënyrë të qartë për të gjitha palët e interesuara në procesin e vlerësimit (të brendshëm dhe të jashtëm) të performancës së shkollës.

1.3 Funksionet e udhëzuesit

Ky udhëzues u shërben *menaxhmentit* të shkollës, Këshillit Drejtues të Shkollës dhe ekipeve të shkollës për planifikimin, përgatitjen dhe realizimin e procesit të vetëvlerësimit. Instrumentet dhe procedurat e vetëvlerësimit shërbejnë për të lehtësuar dhe strukturuar më mirë komunikimin në mes të ekipeve vlerësuese të shkollës dhe palëve (personave) të përfshira në vetëvlerësim. Udhëzuesi shërben edhe për informimin e *ekipeve që bëjnë vlerësimin e jashtëm* për procedurat që duhet të ndjek shkolla gjatë realizimit të vetëvlerësimit.

1.4 Përdorimi i udhëzuesit

Udhëzuesi do të përdoret për të informuar të gjithë komunitetin e shkollës për procesin e vlerësimit të brendshëm të shkollës dhe për ta orientuar e mbështetur zhvillimin e shkollës. Po ashtu, ky udhëzues, do të shërbej edhe për procesin e planifikimit shkollor, organizimit të punës në shkollë dhe për orientimin e punës së ekipeve të shkollës në funksion të përmirësimit dhe avancimit të vazhdueshëm të performancës së shkollës.

1.5 Përmbajtja dhe struktura e udhëzuesit

Ky është një Udhëzues tredimensional (3D) që vetëvlerësimin e analizon nga tri aspekte: aspekti vertikal (fushat e cilësisë); horizontal (kriteret e cilësisë) dhe i thellësisë (treguesit e performancës). Udhëzuesi përfshinë procesin e vetëvlerësimit, hapat e masat për përmirësim dhe instrumentet kryesore për vetëvlerësim.

Vlerësimi i brendshëm duhet të fokusohet në vlerësimin e të gjitha fushave të cilësisë të përcaktuara me Kornizën për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës, në disa nga këto fusha (siç është rregulluar me Udhëzimin administrativ (UA) për Vlerësimin e performancës së institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar), ose edhe në fusha të veçanta (që nuk janë të përfshira në listë), sipas nevojës ad-hoc që vlerësohet nga menaxhmenti ose autoritetet arsimore.

Sipas UA për Vlerësimin e performancës së institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar:

- në vetëvlerësimin e parë të performancës së institucionit arsimor, objekt vlerësimi janë të gjitha fushat e cilësisë;
- në të gjitha vetëvlerësimet pasuese të performancës së institucionit arsimor, objekt vlerësimi janë së paku dy fusha të cilësisë, njëra prej të cilave është **Performanca e nxënësve** dhe tjetra përcaktohet nga vet institucioni arsimor
- institucioni arsimor (shkolla) mund të përcaktohet që vlerësimin ta bëj në më shumë se dy fusha të cilësisë.

2. Konceptet kryesore:

2.1. Vetëvlerësimi

Në Udhëzimin Administrativ për Vlerësimin e Peformancës së institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar, vetëvlerësimi definohet si: „kontroll i planifikuar, sistematik i standardeve në fushat e cilësisë të përcaktuara nga MASHT, i cili kryhet nga shkolla në intervale të rregullta, duke u bazuar në kriteret e cilësisë dhe treguesit e përfomancës siç përshkruhet në Kornizën për sigurim të cilësisë së përfomancës së shkollës”. Procesi i vlerësimit të brendshëm të përfomancës së shkollës, realizohet nga **Ekipi me bazë në shkollë**, duke u bazuar në fushat e cilësisë dhe në Planin zhvillimor të shkollës.

Vetëvlerësimi në shkollë dhe planifikimi zhvillimor në shkollë janë dy anë të të njëjtit proces të përmirësimit të përfomancës së shkollës dhe sigurimit të cilësisë. Ato përbëjnë një cikël të vlerësimit dhe intervenimit të planifikuar e sistematik që për qëllim përfundimtar kanë përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shkollore, bashkëpunimin e komunikimin më të mirë me komunitetin dhe përfundimisht rritjen e kompetencave të nxënësve.

2.2. Vlerësimi i jashtëm

Në Udhëzimin Administrativ për Vlerësimin e Peformancës së institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar, vlerësimi i jashtëm definohet si „kontroll i planifikuar, sistematik i standardeve në fushat e cilësisë të përcaktuara nga MASHT-i, i cili kryhet në intervale të rregullta nga inspektorët e arsimit në bazë të kriterëve të cilësisë dhe treguesve të përfomancës të përcaktuara me Kornizën për sigurimin e cilësisë”. Vlerësimi i jashtëm realizohet nga Ekipi për vlerësim të jashtëm, bazuar në raportin për vetëvlerësim dhe planin zhvillimor të shkollës. Ky ekip formohet nga inspektorati i arsimit në bazë të listës së vlerësuesve të jashtëm të miratuar nga MASHT-i.

Korniza për sigurim të cilësisë së përfomancës së shkollës i standardizon konceptet dhe dispozitat themelore që sigurojnë koherencën në mes të dy formave të vlerësimit të përfomancës në shkollë, përfshirë procedurat, treguesit, kriteret e cilësisë, fushat e cilësisë, nivelet e vlerësimit dhe shkallët e cilësisë së përfomancës së shkollës. Një qasje e tillë siguron pajtueshmëri dhe komplementaritet të aspekteve të vlerësimit të këtyre dy proceseve të vlerësimit të përfomancës së shkollës.

2.3. Plani zhvillimor i shkollës

Sipas Udhëzimit Administrativ, Plani zhvillimor i institucioneve të arsimit parauniversitar Plani Zhvillimor i Shkollës (PZhSh) është „dokument pune i obligueshëm që përgatitet nga institucioni arsimor i bazuar në raportin e vetëvlerësimit dhe që përcakton prioritetet dhe objektivat për përmirësimin e cilësisë së punës së institucionit arsimor në periudhën

afatmesme". PZhSh duhet të hartohet nga çdo institucion arsimor, për një periudhë tre-vjeçare, me mundësi rishikimi vjetor në bazë të gjetjeve vjetore të vetëvlerësimit.

2.4. Plani vjetor i veprimit

Plani vjetor i veprimit është pjesë e PZhSh-së, i cili përcakton (a) prioritetet vjetore të intervenimit, (b) aktivitetet (masat) e nevojshme për realizimin e këtyre intervenimeve, (c) kohën (afatin) e zbatimit të këtyre masave, (d) koston, burimet financiare dhe resurset tjera të nevojshme për realizimin e masave të planifikuara dhe (e) personat përgjegjës për realizimin e masave të përcaktuara dhe mbikëqyrjen e zbatimit të planit vjetor.

2.5. Fushat e cilësisë – aspekti vertikal:

Fushat e cilësisë janë shtyllat kryesore në kuadër të të cilave zhvillohen aktivitetet menaxheriale, arsimore e edukative në shkollë. Fushat e cilësisë janë të përcaktuara në Kornizën për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës dhe shërbejnë për të orientuar dhe për të siguruar koherencë në mes të procesit të vetëvlerësimit dhe të vlerësimit të jashtëm të shkollës. Fushat e cilësisë ndërlidhen me parimet e Kornizës së Kurrikulës të Arsimit Parauniversitar të Kosovës dhe sigurojnë mbulueshmëri të aspekteve të rëndësishme të zhvillimit të shkollës. Autoritetet ose komuniteti i shkollës mund të caktojnë edhe fusha të tjera për vetëvlerësim dhe vlerësim të jashtëm në bazë të kërkesave dhe situatës në kohë të caktuara.

Ministria, autoritetet komunale ose menaxhmenti i shkollës mund të përcaktojnë fushat ad-hoc për vlerësim, varësisht nga zhvillimet aktuale në mjedisin e sektorit të arsimit. Kështu për shembull, ndonjëherë do të jetë me rëndësi dhuna kibernetike, ose vlerësimi i standardizuar ndërkombëtar (PISSA), ose trendët e reja në arsim (Qëllimet e Milemiumit, Arsimi në Europë 2020) e të tjera. Në të gjitha këto raste, autoriteti arsimor që do të caktojë fushat ad-hoc, do të jetë i obliguar t'i përcaktojë njëkohësisht edhe kriteret e cilësisë.

2.6. Kriteret e cilësisë– shtrirja e vlerësimit:

Janë nënndarje të fushave të cilësisë, të cilat janë të përcaktuara në Kornizën për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës dhe që shërbejnë për të siguruar qasje më sistematike gjatë mbledhjes së të dhënave dhe koherencë në mes të dy proceseve (të jashtëm dhe të brendshëm) të vlerësimit. Kriteret e cilësisë përshkruajnë pritshmëritë themelore që duhet të përmbushen nga çdo shkollë që funksionon në Republikën e Kosovës, orientojnë shkollat për avancim të vazhdueshëm të praktikave të tyre ndërsa autoritetet arsimore për avancim të politikave arsimore.

Secila fushë e cilësisë ka nga 5 kritere të vlerësimit, përkatësisht nga një kriter për secilin parim të kurrikulës. Korniza për sigurim të cilësisë ka gjithsej 25 kritere për vlerësimin e performancës së shkollës¹.

2.7. Treguesit e performancës – thellësia:

Janë deklarata afirmative të pritshmërisë së performancës në kuadër të secilit kriter të cilësisë. Treguesit na ndihmojnë për të konstatuar nivelin e performancës së shkollës në raport me pritshmërinë. Ata janë referenca kryesore me rastin e vlerësimit të performancës së shkollës në kuadër të kritereve përkatëse².

¹ Shih Shtojca 1: Korniza e kritereve të cilësisë së performancës së shkollës

² Shih Shtojca 2: Lista e treguesve me pyetjet orientuese dhe sugjerime për mjetet e verifikimit

3. PROCESI I VETËVLERËSIMIT NË SHKOLLË


Ky proces përfshinë një sërë masash e aktiviteteve në mbledhjen e sistemit të dhënave për fushat e cilësisë dhe kriteret e performancës së shkollës. Analiza e këtyre të dhënave pastaj siguron informacione relevante për gjendjen ekzistuese, trendin e performancës së shkollës dhe masat e nevojshme për përmirësimin gjegjësisht avancimin e gjendjes. Intervenimet për përmirësimin (avancimin) e gjendjes bëhen nëpërmjet të PZhSh, gjegjësisht planit vjetor të veprimit, duke iu referuar gjetjeve kryesore të vetëvlerësimit dhe vlerësimit të performancës së shkollës. PZhSh dhe planet vjetore të veprimit shërbejnë edhe për të informuar vlerësimin e jashtëm të shkollës.

3.1 Koha e zbatimit të vetëvlerësimit dhe planifikimit zhvillimor të shkollës

Vetëvlerësimet e rregullta do të bëhen me vendim të Këshillit drejtues të shkollës dhe do të zhvillohen një herë në vit gjatë muajve maj - korrik. Vetëvlerësimet ad-hoc, me kërkesë të autoriteteve ose të komunitetit, do të zhvillohen në kohë dhe me përmbajtje të përcaktuar në kërkesën përkatëse.

Plani Zhvillimor i Shkollës hartohet në gjashtëmujorin e parë të vitit, ndërsa i referohet tri viteve pasuese fiskale (konform procedurave buxhetore). Rishikimi vjetor i PZhSh dhe hartimi i Planit vjetor të veprimit bëhet gjatë muajve korrik-gusht të secilit vit shkollor, në bazë të gjetjeve nga vetëvlerësimi i shkollës. Zbatimi i planit vjetor fillon me fillimin e vitit shkollor.

Paraqitjet grafike të procesit të vetëvlerësimit dhe planifikimit zhvillimor të shkollës



3.2 Hapat kryesorë të procesit të vetëvlerësimit

Faza përgatitore:

Menaxhmenti i shkollës e formon ekipin për vetëvlerësim (EVV) prej tre ose pesë anëtarësh si dhe e cakton koordinatorin e ekipit³. Anëtarë të ekipit për vetëvlerësim mund të jenë: koordinatori për cilësi, përfaqësues nga mësimdhënësit dhe nga shërbimi profesional i institucionit arsimor. Në vendimin për formimin e Ekipit përcaktohen edhe fushat e cilësisë që do të jenë objekt i vetëvlerësimit si dhe përshkruhen mjetet dhe dispozitat që i krijojnë kushte EVV-së për të zbatuar mandatin e vet (këtu do të përfshihej edhe qasja e papenguar në të gjitha burimet e mundshme të informatave). Ekipin për vetëvlerësim e udhëheq Koordinatori për cilësi, respektivisht personi që e mbulon pozitën e koordinatorit të cilësisë.

Ekipi për vetëvlerësim mban mbledhjen e vet konstitutive nën drejtimin e drejtorit të shkollës. Të gjitha mbledhjet e tjera organizohen dhe drejtohen nga Koordinatori. Po në mbledhjen konstitutive EVV do të bëjë (i) ndarjen e detyrave dhe roleve dhe (ii) do të hartojë planin e vet të punës për realizimin e vetëvlerësimit. Plani duhet të përfshijë aktivitetet kryesore të procesit (përzgjedhja e pjesëmarrësve në vetëvlerësim, përgatitja e instrumenteve, mbledhja e të dhënave, analiza e të dhënave, vlerësimi, ...), kohën dhe afatet e zbatimit të secilit aktivitet, personat përgjegjës, si dhe resurset e nevojshme për zbatim. Plani dorëzohet për miratim nga drejtori i shkollës, i cili bën edhe monitorimin e zbatimit të tij.

Organet qeverisëse dhe profesionale të shkollës si dhe të gjithë mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit e planifikuar për të marrë pjesë në vetëvlerësim duhet të njoftohen për qëllimin e vetëvlerësimit dhe dinamikën e realizimit, gjegjësisht afatet kohore kur pritet kontributi i tyre.

Hapi 1: Identifikimi i burimit të të dhënave

Bazuar në fushat e cilësisë që janë objekt i vetëvlerësimit, respektivisht analizës së kritereve të cilësisë dhe treguesve të performancës në kuadër të atyre fushave, EVV përgatit:

- (a) listën e dokumentacionit shkollor që do të analizohet
- (b) listën e pjesëmarrësve në vetëvlerësim.

(a) Dokumentacioni që duhet të analizohet nga EVV mund të përmblihet në:

- *Analizën e legjislacionit dhe politikave arsimore*
- *Analizën e dokumentacionit shkollor*

³ Roli i Ekipit të vetëvlerësimit është realizimi i vlerësimit të brendshëm të shkollës, por mund të përfshij edhe përgatitjen e planit vjetor të veprimit dhe monitorimin e zbatimit të planit vjetor. Për realizimin e vetëvlerësimit në vitin vijues, shkolla nxjerr Vendim të ri për themelimin e ekipit të vetëvlerësimit- me ç'rast nuk përjashtohet mundësia e rizgjedhjes së një apo më tepër anëtarëve të njëjtë.

- planin e fundit zhvillimor të shkollës,
- planet vjetore të shkollës (për periudhën që mbulohet nga plani zhvillimor) dhe
- raportin e vetëvlerësimit të fundit të shkollës.

Dokumentet tjera shkollore, të cilat mund të shfrytëzohen si burime të të dhënave (varësisht nga fushat e cilësisë të cilat janë në fokus të vlerësimit), përfshijnë:

- Procesverbalet dhe vendimet e mbledhjeve të ndryshme të mësimdhënësve (në kuadër të organeve profesionale të shkollës),
- Procesverbalet dhe vendimet e mbledhjeve të ndryshme të organeve qeverisëse,
- Dëshmitë e procesit të hartimit të PZhSh
- Dëshmitë e procesit të vetëvlerësimit të shkollës
- Planet e shkollës për zhvillim profesional
- Planet individuale zhvillimore të mësimdhënësve
- Raporte nga seancat e zhvillimit profesional të mësimdhënësve me bazë në shkollë ose jashtë shkollës
- Materialet dhe produktet e ZhPM (*portfolio, materiale mësimore, certifikata, procesverbale nga seanca reflektimi etj.*)
- Mostrat e planeve mësimore (*planet për shkollë, planet vjetore, mujore, ditore*)
- Kurrikula me bazë në shkollë, përfshirë kriteret në bazë të të cilave shkolla është përcaktuar për KBSH
- Mostrat e materialeve mësimore të përdorura nga mësimdhënësit
- Raportet e shkollës mbi nivelin e përgjithshëm të performancës së nxënësve në zotërimin e kompetencave kryesore
- Raportet e shkollës mbi nivelin e përgjithshëm të arritshmërisë së nxënësve në rezultate të përcaktuara për fushat kurrikulare
- Mostrat e PIA-së të nxënësve
- Mostrat e punimeve të nxënësve (*testeve, eseve, punimeve në fushën e artit, etj.*)
- Mostrat e projekteve të realizuara me iniciativë të nxënësve, etj.

(b) Kriteret kryesore për përzgjedhjen e nxënësve që drejtpërdrejtë do të përfshihen në vetëvlerësim janë:

- *Nxënës me performancë të lartë, të mesme dhe të ulët,*
- *Nxënës me prirje të theksuara dhe nxënës me nevoja të veçanta ,*
- *Nxënës nga shkollë të ndryshme kurrikulare,*
- *Nxënës me prejardhje të ndryshme familjare,*

Numri i nxënësve të përzgjedhur nuk duhet të jetë më i vogël se 10, në mënyrë që të sigurohet respektimi i këtyre kriterëve të përfaqësimit.

Mësimdhënësit do të përzgjidhen nga ekipi i mësimdhënësve që punojnë me nxënësit e përzgjedhur. Numri i mësimdhënësve duhet të përbëjë së paku 60 % të mësimdhënësve që punojnë me nxënësit e përzgjedhur.

Prindërit që do të marrin pjesë në vlerësim janë prindërit e nxënësve të përzgjedhur.

Pjesëmarrës të tjerë në vetëvlerësim mund të jenë personeli i shërbimit profesional, kryesuesit dhe (apo) anëtarët e aktiveve profesionale, përfaqësues të organeve qeverisëse, udhëheqëse, administrative e teknike të shkollës, varësisht nga objekti i vlerësimit të performancës së shkollës.

Në Shtojcën 2 të këtij doracaku është dhënë lista e treguesve me pyetje orientuese dhe mjetet e verifikimit (burimet) të të dhënave në kuadër të secilit kriter. Pyetjet orientuese përmbajnë aspektet kryesore për të cilat ju duhet të merrni përgjigje me rastin e konstatimit të gjendjes në raport me treguesit. Prandaj, duhet të analizohen me kujdes dhe të shfrytëzohen si orientim për përzgjedhjen e burimeve, për përzgjedhjen e teknikave për mbledhjen e të dhënave, për përpilimin e pyetjeve, për mbledhjen e të dhënave si dhe për analizën e të dhënave të mbledhura.

Hapi 2: Përgatitja e instrumenteve të vlerësimit

Përzgjedhja e teknikave të cilat do të aplikohen dhe përpilimi i instrumenteve përkatëse bëhet në bazë të treguesve të përcaktuar për secilin kriter të vlerësimit, në kuadër të fushave të cilësisë, që janë në fokus të vlerësimit të brendshëm.

Përzgjedhja e teknikave dhe instrumenteve adekuate të vlerësimit për të mbledhur informacion ose dëshmi i ndihmon konsistencës, objektivitetit dhe saktësisë në procesin e mbledhjes së informacioneve. Kjo i kontribuon arritjes së konkluzioneve të besueshme dhe të vlefshme të vlerësimit në lidhje me aspektet relevante të punës së shkollës.

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë disa teknika dhe instrumente që mund të merren në konsideratë.

Teknikat	Instrumentet	Aspekte praktike
<i>Analizë e dokumentacionit</i>	<i>Lista kontrolluese</i>	<p><i>Lista kontrolluese për analizën e dokumentacionit duhet të përmbajë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Listën e dokumentacionit që do të shqyrtohet dhe</i> - <i>Aspektet kryesore që do të analizohen</i> <p><i>Lista e dokumenteve që do të analizohen përpilohet me kujdes duke iu referuar treguesve të përcaktuar për secilin kriter në kuadër të fushave që janë në fokus të vlerësimit.</i></p>

Intervistat	Protokolli i intervistës	<p>Intervistat mund të gjenerojnë informacione të pasura lidhur me temën dhe me nëntemat e caktuara për vlerësim. Ato mund të realizohen me personelin udhëheqës, profesional, mësues dhe teknik të shkollës, me prindër, nxënës, etj. Intervistat duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përmbajnë një numër jo të madh të pyetjeve të thjeshta e të qarta , - të zhvillohen brenda afatit të planifikuar, - të zhvillohen në bazë të protokollit të përgatitur, - të jenë fleksibile për të reaguar ndaj temave dhe mendimeve që dalin paplanifikuar.
Analizë e perceptimeve	Pyetësi	<p>Perceptimet e mësuesve, të prindërve, të nxënësve, etj., janë shumë të rëndësishme për aspekte të caktuara të vlerësimit të shkollës dhe sidomos për aspektet e përfshirjes dhe kulturës së shkollës. Gjatë hartimit të pyetësorëve duhet të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përcaktohen (paraprakisht) informacionet që synohen të mblidhen, - shpjegohet arsyeshmëria për realizimin e pyetësorit, - sigurohet anonimiteti dhe konfidencialiteti, - shmangen pyetjet e panevojshme, - shmangen pyetjet sugjестive, - strukturohet pyetësi në mënyrë të qartë dhe logjike
Observimi/ vëzhgimi	Protokolli i vëzhgimit	<p>Vëzhgimi është teknikë shumë e rëndësishme për vlerësimin e performancës së shkollës dhe sidomos për vlerësimin e dimensionit Mësimdhënia dhe të nxënësve.</p> <p>Me rastin e vëzhgimit të orëve mësimore, EVJ nuk duhet të kufizohet në ndonjë formë të preferuar të mësimdhënies, por në efektivitetin e mësimdhënies dhe nxënësve për realizimin e qëllimeve të përcaktuara për orën mësimore. Më këtë rast vëzhgohet edhe klima e përgjithshme në klasë, interesimi dhe pjesëmarrja e nxënësve në procesin mësimor, komunikimi, vlerësimi për të nxënë, etj. Kështu vëzhgimi shfrytëzohet për plotësimin e informacionit të mbledhur përmes analizës së dokumentacionit shkollor. Në raport me instrumentet tjera, vëzhgimi mund të shfrytëzohet para apo pas realizimit të intervistave dhe pyetësorëve.</p> <p>Protokolli i vëzhgimit duhet të jetë i fokusuar në aspektet të cilat janë objekt i vlerësimit. Vëzhgimi duhet të mbulohet me së paku 60% të mësuesve të cilët</p>

		<p><i>punojnë me nxënësit e përzgjedhur si pjesëmarrës në vlerësim.</i></p> <p><i>Një informacion i shkurtër kthyes mbi gjetjet kryesore dhe një mundësi për reflektim duhet të ofrohet për mësimdhënësin, menjëherë pas përfundimit të vëzhgimit.</i></p> <p><i>Vëzhgimi mund të shfrytëzohet edhe për vlerësimin e dimensioneve të tjera (kultura dhe mjedisi shkollor dhe Performanca e nxënësve), me ç'rast protokollin e vëzhgimit duhet të përpilohet duke iu referuar treguesve të përcaktuar për secilin kriter që synohet të vlerësohet përmes këtij instrumenti.</i></p>
Fokus grupet	<i>Agjendat e takimeve me fokus grupe</i>	<p><i>Grupet e fokusit shërbejnë për hulumtim më të thellë të temave, pyetjeve, çështjeve dhe informatave që janë mbledhur gjatë fazave paraprake përmes studimit të dokumenteve, pyetësorëve, intervistave dhe vëzhgimeve.</i></p> <p><i>Përbërja e Fokus-grupit kufizohet në 6-13 pjesëmarrës.</i></p> <p><i>Moderatori i diskutimit ka rol thelbësor, pasi që ai mundëson diskutim me pjesëmarrje të barabartë, reflektim dhe sqarim e të kuptuar më të thellë të ideve.</i></p> <p><i>Para përfundimit të diskutimit, pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të reflektojnë dhe të sqarohen për çështjet e diskutuara në mënyrë që të arrihet një konsensus për konkluzionet e fokus-grupit mbi çështjet e diskutuara.</i></p>

Në Shtojcën 3 të këtij Udhëzuesi është dhënë një tabelë e cila mund të shfrytëzohet për identifikimin e burimeve dhe instrumenteve për mbledhjen e të dhënave. Për të lehtësuar punën e EVV-së në këtë proces, tabela është plotësuar me burimet e mundshme dhe instrumentet për fushën e cilësisë: Menaxhimi dhe qeverisja. Sipas atij modeli, EVV mund të vazhdojë identifikimin e burimeve dhe instrumenteve edhe për treguesit/kriteret/fushat tjera të cilësisë.

Pas identifikimit të burimeve dhe instrumenteve, EVV mund të bëjë sistemimin e instrumenteve të përzgjedhura për mbledhjen e të dhënave. Në Shtojcën 4 është dhënë një tabelë e cila mund të shfrytëzohet për këtë qëllim. Në kolonën e parë të kësaj table, fillimisht, listohen të gjitha instrumentet e përzgjedhura (të evidentuara në tabelën paraprake). Për secilin instrument listohen treguesit për të cilët është planifikuar shfrytëzimi i instrumentit përkatës. Edhe kjo tabelë është plotësuar për fushën e cilësisë: Menaxhimi dhe qeverisja, ndërsa EVV duhet të vazhdojë plotësimin e instrumenteve tjera të identifikuara (për kriteret/fushat tjera të cilësisë) si dhe treguesit për të cilët janë planifikuar instrumentet përkatëse.

Ky sistemim i instrumenteve të përzgjedhura ndihmon EVV-në me rastin e përgatitjes së instrumenteve, duke siguruar që secili instrument t'i mbuloj të gjitha çështjet për të cilat është planifikuar të shfrytëzohet.

Me rastin e përgatitjes së instrumenteve, EVV duhet të ketë parasysh se pyetjet orientuese (të dhëna në Shtojcën 2) përmbajnë orientimet e përgjithshme të mbulueshmërisë së secilit tregues dhe duhen shfrytëzuar për t'i mbajtur të fokusuar instrumentet për mbledhjen e të dhënave. Pyetjet orientuese përmbajnë aspektet kryesore për të cilat EVV duhet të ofroj përgjigje me rastin e përshkrimit të gjendjes në raport me treguesit. Por, këto pyetje nuk duhet të shfrytëzohen si të tilla në instrumentet për mbledhjen e të dhënave nga pjesëmarrësit në vetëvlerësim. Disa mostra të instrumenteve janë dhënë në Shtojcën 9.

Hapi 3: Mbledhja e të dhënave

Ekipi për vetëvlerësim (EVV) është përgjegjës për organizimin dhe administrimin e procesit të mbledhjes së të dhënave për vetëvlerësim. Të dhënat e mbledhura mund të jenë sasiore dhe cilësore. Të dhënat do të mblidhen nga mësimdhënësit, nxënësit, prindërit, menaxhmenti, personeli administrativ në hapësirat brenda dhe jashtë shkollës. Për këtë qëllim, EVV do të përdorë një sërë instrumentesh dhe teknikash për mbledhjen e të dhënave: pyetësorë, anketa, lista kontrolluese, udhëzues për grupe fokusi e të tjera. EVV mund të përdorë edhe mjete e burime të tjera të informacioneve si kuti të përshtypjeve, platformë elektronike (online), statistikat e komentet nga përdorimi i faqeve të rrjeteve sociale, përshtypjet e prindërve nga ditët e shkollës, ditët e hapura, ngjarjet e ndryshme festive, vizitat e organizuara të anëtarëve të EVV në komunitet, bisedat gjysmë të kontrolluara me organet e shkollës, etj.

Qasjet, metodat dhe instrumentet e diskutuara në Hapin 2, janë paraqitur me qëllim të ofrimit të udhëzimeve praktike për ekipet e vetëvlerësimit të shkollës për mbledhjen e informacioneve dhe dëshmime gjatë vetëvlerësimit të performancës së shkollës. Instrumentet mostër janë dhënë në pjesën e shtojcave të këtij doracakut (shih Shtojcën 9). Është e vetëkuptueshme që instrumentet e dhëna në këtë udhëzues janë vetëm mjete orientuese dhe se shkollat do të përdorin këto instrumente në mënyrë fleksibile. Ekipi shkollor për vetëvlerësim duhet t'i përshtatë ato konform aspekteve konkrete që janë objekt i vlerësimit, ose të zhvillojë instrumente plotësuese. Për t'i siguruar të gjitha të dhënat dhe dëshmitë e nevojshme, shërbehuni me pyetjet orientuese të dhëna në Shtojcën 2, për secilin tregues të performancës.

Hapi 4: Analiza e të dhënave të mbledhura

Të dhënat do të mblidhen dhe do të analizohen duke i pasur vazhdimisht në mend kriteret e cilësisë.

Fushat e cilësisë, kriteret e cilësisë dhe me theks të veçantë treguesit e hartuar për secilin kriter, do të shërbejnë për ta bërë të matshëm nivelin e performancës së shkollës dhe për të

identifikuar sfidat për secilën fushën të cilësisë. Treguesit e performancës do ta bëjnë më të lehtë mbledhjen e të dhënave dhe informacioneve për gjendjen aktuale në fushën përkatëse, por edhe për ndërmarrjen e masave për përmirësim. Për ilustrim, marrim shembullin e fushës së zhvillimit profesional të mësimitdhënësve (ZhPM). Aspekti gjithëpërfshirës (nga KKAP) në ZhPM, përkatësisht kriteret e ZHP do të mund të vlerësohen duke krahasuar të dhënat për pjesëmarrësit e ngjarjeve të ndryshme të ZhP, në shkollë, dhe duke e krahasuar atë me të dhënat e të punësuarve. Kështu, mund të kuptojmë, për shembull, se nga 60 mësimitdhënës, 20 prej tyre kanë përfituar nga tri mundësi aftësimi jashtë shkollës, 15 nga dy mundësi, 10 nga një mundësi ndërsa 15 vetave nuk u është ofruar – ose nuk kanë qenë të gatshëm të përfitojnë nga asnjë mundësi aftësimi. Ngjashëm, edhe aspekti i zhvillimit të kompetencave do të mund të vlerësohet duke krahasuar arritshmërinë e nxënësve në lëndën e caktuar me (mos) pjesëmarrjen në ngjarje të zhvillimit profesional nga ana e mësimitdhënësve individualë. Në këtë segment, po ashtu, do të mund të organizoheshin intervista me mësimitdhënës për të parë ndërlidhjen në mes të zhvillimit profesional dhe zhvillimit të kompetencave të nxënësve. Pastaj, rezultatet e intervistës do të mund të *analizoheshin* kundrejt kriterit përkatës (shih përfundimet në vijim).

Me rastin e analizës së të dhënave, ju duhet të siguroheni se të dhënat dhe dëshmitë e mbledhura ju mundësojnë t'i përgjigjeni pyetjeve të dhëna në Shtojcën 2, për secilin tregues të performancës.

Hapi 5: Përfundimet (Vlerësimi i cilësisë)

Ashtu siç janë caktuar kriteret e cilësisë për secilën fushë të cilësisë, njësoj janë caktuar edhe treguesit për secilin kriter. Treguesit e performancës shërbejnë për të bërë analizën më të thellë të gjendjes dhe për të arritur në përfundimet për fushën e caktuar të pasqyruar në kriteret.

Për vlerësimin e cilësisë së performancës së shkollës janë dhënë katër shkallë të cilësisë⁴. *Konstatimi i gjendjes dhe vlerësimi i cilësisë së performancës për secilin kriter të cilësisë dhe për secilën fushë bëhet në bazë të gjetjeve të evidentuara gjatë procesit të vlerësimit, duke shfrytëzuar si referencë treguesit e performancës së shkollës*⁵. Pra, treguesit janë referencë e aspekteve që duhen vlerësuar.

Në nivel të kriterëve të cilësisë, për secilin tregues përshkruhet gjendja dhe trendi i performancës së shkollës, në bazë të analizës së të dhënave të mbledhura gjatë procesit të vlerësimit. Në vijim janë dhënë disa sqarime më konkrete të vlerësimit të performancës së shkollës në nivel të kriterëve.

⁴ Shih Shtojca 4: Shkallët e cilësisë së performancës së shkollës

⁵ Shih Shtojca 2: Treguesit e performancës së shkollës

Tabela e shfrytëzuar për këtë shembull është pjesë e Formularit për vlerësimin e performancës së shkollës⁶.

Fusha e cilësisë 1: MENAXHIMI DHE UDHËHEQJA	
Kriteri 1.1: Organet e qeverisjes janë funksionale dhe efektive në përfaqësimin e interesave të komunitetit të shkollës	
Treguesit	Trendi
<p>1.1.1 <i>Në këtë hapësirë (dhe në vijim) konstatohet gjendja për treguesin përkatës, në bazë të gjetjeve të evidentuara gjatë procesit të vlerësimit. Performanca e shkollës në raport me treguesin përkatës mund të përshkruhet duke u përgjigjur në pyetjet e dhëna në Shtojcën 2, për treguesin përkatës. Por, kjo përgjigje duhet të jetë e bazuar në të dhënat dhe dëshmitë e mbledhura gjatë vetëvlerësimit.</i></p> <p><i>Kini kujdes: në Formularin e dhënë tek Shtojca 5, hapësira e vënë në dispozicion për të përshkruar gjendjen për tregues është ndarë në atë mënyrë që një kriter të përfshihet brenda një faqeje. Mirëp, me rastin e nxjerrjes së përfundimeve tuaja (pra me rastin e plotësimit të kësaj pjese ju shfrytëzoni aq hapësirë sa të ju nevojitet sepse nuk ka nevojë të respektohet hapësira që është në dispozicion).</i></p> <p><i>E rëndësishme është që informacioni të jetë konciz, përshkruar (jo gjykues), i saktë, i bazuar dhe relevant për treguesin përkatës.</i></p>	p.sh. stagnim
1.1.2	
1.1.3	
...	
Shkalla e cilësisë: p.sh. Performancë e pranueshme (2)	

Pra, vlerësimi i performancës në raport me kriteret e vlerësimit është një përshkrim i gjendjes së evidentuar dhe trendit të performancës së shkollës⁷ në raport me secilin tregues të kriterit përkatës. Në bazë të gjendjes së evidentuar dhe trendit të performancës për secilin tregues, përcaktohet dhe shkalla e cilësisë së performancës për kriterin përkatës⁸.

Vlerësimi i performancës së shkollës **në nivel të fushave të cilësisë** duhet të përmbajë:

- Përcaktimin e shkallës së cilësisë së performancës në fushën përkatëse,
- Përmbledhjen e gjendjes reale të shkollës në kuadër të fushës përkatëse, duke u bazuar në gjetjet e evidentuara në raport me treguesit për secilin kriter të fushës përkatëse,
- Paraqitjen e evidencave (dëshmime) që mbështesin gjetjet e konstatuara në raport me treguesit, për secilin kriter të fushës përkatëse, dhe

⁶ Shih Shtojca 5: Formulari për vlerësimin e performancës së shkollës

⁷ Shih Shtojca 3: Shkalla për përcaktimin e trendit të performancës së shkollës

⁸ Shih Shtojca 4: Shkallët e cilësisë së performancës së shkollës

- Konstatimin e trendit (krahasuar me vlerësimin paraprak), evidentimin e ndikimit negativ apo pozitiv të faktorëve që janë jashtë kontrollit të institucionit arsimor dhe masat që do të ndërmerren nga shkolla për adresimin e këtyre ndikimeve.

Tabela në vijim është pjesë e Formularit të vlerësimit të performancës së shkollës që i referohet vlerësimit në nivel të fushave të cilësisë⁹. Në hapësirat përkatëse janë dhënë sqarimet për plotësim.

Vlerësimi i fushës së cilësisë		
Fusha e cilësisë: MENAXHIMI DHE QEVERISJA		
Shkalla e cilësisë:		
Përshkrim i performancës së shkollës	Dëshmitë/evidencat	Sqarime
<p><i>Konstatohet gjendja reale e shkollës në kuadër të fushës përkatëse përmes një përshkrimi përmbledhës të gjetjeve në nivel të kriterëve. Për secilën fushë konstatohen përparësitë dhe dobësitë e performancës së shkollës në raport me pritshmëritë e përcaktuara në Kornizën e Vlerësimit të Performancës së Shkollës.</i></p> <p><i>p.sh.</i> Udhëheqja e shkollës bën përpjekje që të zbatojë praktika gjithëpërfshirëse në menaxhimin dhe udhëheqjen e shkollës. Bashkëpunimi me nxënës dhe mësime për të zhvilluar dhe formësuar një vizion të përbashkët ka qenë sporadik dhe i pa-evidentuar mjaftueshëm. Shkolla ka bërë përpjekje që të zbatojë vetëvlerësimin e shkollës, por raportet e vetëvlerësimit kanë mangësi evidente dhe nuk paraqesin situatën reale dhe problematikat me të cilat ballafaqohet shkolla. Disa nga mekanizmat e qeverisjes në shkollë janë vendosur në mbështetje të kërkesave të parimit gjithëpërfshirës, por në të shumtën e rasteve nuk janë funksional dhe pak arrijnë të zbatojnë praktikat efektive të arritjes së qëllimeve arsimore shkollë dhe kombëtare. Shkolla nuk ka një plan</p>	<p><i>Ligjet (dokumentet) përkatëse rregullative</i> <i>p.sh.</i> <i>Ligji për Arsimin Parauniversitar në Kosovë</i> <i>...</i> <i>Lista e dëshmimeve të performancës</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Plani Zhvillimor i Shkollës</i> - <i>Raporti i vetëvlerësimit të shkollës</i> - <i>Vendimi për themelimin e KN</i> - <i>Procesverbalet dhe listat e pjesëmarrësve në takimet e KN gjatë vitit të fundit</i> - <i>Procesverbalet dhe listat e pjesëmarrësve në takimet e KP gjatë vitit të fundit</i> - <i>Të dhënat nga intervista e realizuar me NN, Kryesues i Këshillit të Prindërve (datë)</i> - <i>Të dhënat nga intervista e realizuar me NN, Kryetar i Bordit të Shkollës (datë)</i> - <i>Të dhënat nga intervista e realizuar me Drejtorin e shkollës (datë xx.xx.xxxx),</i> - <i>Të dhënat nga anketa e aplikuar me XY nxënës për identifikimin e perceptimeve</i> 	<p><i>Trendi, krahasuar me vlerësimin paraprak</i></p> <p><i>Kufizimet/përparësitë nga faktorët jashtë kontrollit të shkollës</i></p> <p><i>Masat që duhet të ndërmerren nga shkolla</i></p>

⁹ Shih Shtojca 5: Formulari për vlerësimin e performancës së shkollës

aktivitetesh për të funksionalizuar të gjithë mekanizmat e nevojshëm për udhëheqje efektive të shkollës dhe për të siguruar përfaqësim të interesave të komunitetit të shkollës në qeverisjen e shkollës. Nxënësit nuk ndjehen të vlerësuar pasi që ata kanë mundësi për të shprehur qëndrimet e tyre por ato zakonisht nuk merren parasysh në proceset vendimmarrëse të shkollës.	<p>të tyre mbi prioritetet që duhen adresuar në shkollë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të dhënat nga anketa e aplikuar me X Y prindër mbi prioritetet që duhen adresuar në shkollë - Raporti nga takimi me fokus grupin e nxënësve 	
--	--	--

Vlerësimi i performancës së përgjithshme të shkollës përban një përmbledhje të gjendjes së konstatuar në nivel të fushave të cilësisë që kanë qenë objekt i vetëvlerësimit dhe vlerësimit të shkollës. Ky vlerësim bëhet nga perspektiva e ndikimit që kanë pasur praktikat shkollore të nxënësit dhe nxënia e tyre.

Me rastin e vlerësimit të përgjithshëm, shkolla identifikon edhe përparësitë dhe dobësitë e performancës së saj dhe masat që duhet të ndërmerren për (i) mirëmbajtjen dhe avancimin e përparësive dhe (ii) përmirësimin e anëve të dobëta, respektivisht tejkalimin e sfidave të evidentuara.

Tabela në vijim është pjesë e Formularit të vlerësimit të performancës së shkollës¹⁰. Në hapësirat përkatëse janë dhënë sqarimet për plotësim.

NIVELI I PËRGJITHSHËM I PERFORMANCËS SË SHKOLLËS		
Shkalla e cilësisë: <i>(konstatohet shkalla e cilësisë së performancës sipas udhëzimeve më lart, p.sh. performancë e mirë, performancë e pranueshme, apo tjetër)</i>		
Përshkrimi i performancës së përgjithshme	Përparësitë dhe dobësitë e evidentuara	Rekomandime
<i>Përshkruhet performanca e shkollës përmes një përmbledhje të gjetjeve në nivel të fushave të cilësisë.</i>	<p><i>Zhvillimet e përgjithshme</i></p> <p><i>Trendi, krahasuar me vlerësimin paraprak.</i></p> <p><i>Përkushtimi i shkollës për përmirësim</i></p> <p><i>Anët e forta dhe sfidat kryesore të shkollës</i></p> <p><i>Kufizimet/përparësitë nga faktorët jashtë kontrollit të shkollës</i></p>	<i>Rekomandimet për punën e mëtejme të shkollës në adresimin e sfidave dhe përforcimin e anëve të forta.</i>

¹⁰ Shih Shtojca 7: Formulari për vlerësimin e performancës së shkollës

Hapi 6: Raporti përmbledhës i vetëvlerësimit (RVV):

Procesi i vetëvlerësimit shërben për të drejtuar procesin e intervenimit të planifikuar për përmirësim ose avancim të performancës së shkollës. Ky raport duhet të shfrytëzohet si bazë për diskutim dhe reflektim në mesin e mësimit, menaxhmentit dhe komunitetit të shkollës, përkitazi me performancën, misionin dhe rolin e shkollës. Raporti i shërben edhe Këshillit drejtues të shkollës për raportim dhe informim të prindërve, komunitetit dhe autoriteteve.

Ky është një raport i thukët prej 3-5 faqesh, në të cilin paraqiten përparësitë dhe mangësitë kryesore të konstatuara gjatë procesit të vetëvlerësimit. Në fakt, në raportin përmbledhës vetëm barten vlerësimet nga Formulari i vetëvlerësimit (vlerësimi i përgjithshëm, vlerësimi i fushave të cilësisë dhe vlerësimi i kriterëve) në pjesët përkatëse¹¹. Ky raport shërben si për planifikimin e masave për përmirësim/avancim të shkollës ashtu edhe për informimin e vlerësimeve të jashtme të performancës së shkollës.

Raportin e vetëvlerësimit e harton Ekipi për Vetëvlerësim (EVV) dhe ia dorëzon drejtorit të shkollës. Pas aprovimit nga Këshilli drejtues i Shkollës, raporti do të jetë bazë për rishikim të Planit Zhvillimor të Shkollës dhe për përgatitjen e Planit vjetor të veprimit. Ky raport, pos nga Këshilli i shkollës, do të përdoret edhe nga vlerësuesit e jashtëm, nga DKA, etj.

3.3. Shfrytëzimi i gjetjeve të vetëvlerësimit

Raporti i vetëvlerësimit duhet të shërbejë për të orientuar veprimin konkret për përmirësim, respektivisht avancim të gjendjes në shkollë. Vendosja e caqeve specifike të bazuara në vlerësimin e performancës së shkollës, në nivel të fushave të cilësisë, është pika fillestare e veprimit për përmirësim. Informata përkatëse për cilësinë e performancës së shkollës i dërgohet Këshillit drejtues të shkollës.

Pas shqyrtimit të raportit, Këshilli drejtues do të vendosë për përparimin që pritet të shënohet gjatë vitit të ardhshëm për secilën fushë të cilësisë. Është mirë që Këshilli të përfshijë sa më shumë veta nga kolektivi i shkollës dhe nga komuniteti në diskutimin e shkollës së arritur të performancës dhe në vendimmarrje lidhur me shkallën e aspiruar të performancës.

Këshilli, gjithashtu do të diskutojë dhe do të miratojë caqet konkrete që duhen realizuar brenda një viti me qëllim të përmirësimit të gjendjes¹². Këto caqe do të jenë specifike, të

¹¹ Shih Shtojca 8: Struktura e përmbajtjes së raportit përmbledhës të vetëvlerësimit

¹² Ky Udhëzues i është referuar procesit të rregullt vjetor të vetëvlerësimit të shkollës, në bazë të të cilit rishikohet PZhSh dhe përpilohet Plani vjetor i veprimit. Duke marrë parasysh faktin që vetëvlerësimi i parë në shkollë do t'i mbulojë të gjitha fushat e cilësisë, ky udhëzues do të shërbejë për planifikimin zhvillimor të shkollës, për një periudhë se paku 3 vjeçare. Vetëvlerësimet e rregullta që pasojnë në baza vjetore mund të fokusohen në, së

matshme, të arritshme, realiste dhe me afate të sakta kohore (SMART). Për shembull, shkolla mund të vendosë që „Të gjithë mësimitdhënësit do të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga mundësitë e zhvillimit profesional jashtë shkollës”, ose „Së paku 70 % e mësimitdhënësve do të angazhohen në vëzhgimin e ndërsjellë dhe në veprimet përcjellëse”, „Të gjithë mësimitdhënësit e shkencave natyrore do të realizojnë së paku një javë të projekteve me nxënësit e vet gjatë gjysmë vjetorit të dytë“. Caqet janë vendimtare për përcaktimin e veprimeve që do të ndërmerren.

Bazuar në këto prioritete të intervenimit që vendosen nga Këshilli drejtues, shkolla inicion procesin e rishikimit të Planit Zhvillimor dhe hartimit të Planit vjetor të veprimit¹³. Plani do të ndërtohet mbi (i) raportin e vetëvlerësimit, (ii) rekomandimet e Ekipit vlerësues, (iii) vendimin e Këshillit drejtues për shkallën e përmirësimit sipas fushave të cilësisë dhe (iv) vendimin e Këshillit drejtues për caqet e përmirësimit¹⁴.

paku, dy fusha të cilësisë dhe të shërbejnë për përpilimin e planit vjetor të veprimit si dhe për rishikimin e planit zhvillimor të shkollës.

¹³ Në Shtojcën 10 është dhënë forma e Planit Vjetor të Veprimit

¹⁴ Procesi i hartimit dhe aprovimit të Planit zhvillimor të shkollës dhe Planeve vjetore të veprimit është rregulluar me Udhëzimin Administrativ të Planit Zhvillimor të institucioneve të arsimit parauniversitar, ndërsa mekanizmat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë janë përcaktuar me Udhëzimin Administrativ Për Sigurim të Cilësisë në arsimin parauniversitar;

Shtojca

Shtojca 1: Korniza e kriterëve të cilësisë së performancës së shkollës

PARIMET E KKAJ	FUSHAT E PERFORMANCËS SË SHKOLLËS				
	1 MENAXHIMI DHE QEVERISJA	2 KULTURA DHE MJEDISI	3 MËSIMDHËNIA DHE NXËNIA	4 ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËS VE	5 PERFORMANCA E NXËNËSVE
KRITERET E VLERËSIMIT					
GJITHËPËRFSHIRJA	1.1 Organet e qeverisjes janë funksionale dhe efektive në përfaqësimin e interesave të komunitetit të shkollës	2.1 Objekti dhe hapësirat përcjellëse të shkollës janë të qasshme, të sigurta, të shëndetshme dhe miqësore	3.1 Shkolla siguron përfshirjen e nxënësve dhe prindërve në aktivitetet mësimore	4.1 Menaxhmenti i shkollës, në planifikimin e ZhPM, përfshin nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit	5.1 Nxënësit ushtrojnë përgjegjësitë e veta sociale e qytetare në klasë, në shkollë dhe në komunitet
ZHVILLIMI KOMPETENCAVE	1.2 Shkolla ka në fokus të orientimit strategjik zhvillimin e kompetencave të nxënësve	2.2 Shkolla siguron për të gjithë nxënësit mundësi të barabarta për zotërimin e kompetencave	3.2 Aktivitetet mësimore mundësojnë mbështetje të diferencuar të nxënësve për zotërimin e kompetencave dhe zhvillimin e potencialit	4.2 Praktikat e zhvillimit profesional të mësimdhënësve janë në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve	5.2 Arritshmëria dhe progresi i nxënësve në zotërimin e kompetencave kryesore plotëson pritshmërinë e vendosur me KB
MËSIMDHËNIA DHE NXËNIA E INTEGRUAR	1.3 Organet profesionale të shkollës janë funksionale dhe efektive në jetësimin e mësimin të integruar	2.3 Mjedisi dhe kultura e punës së shkollës janë në funksion të nxënies së integruar dhe jetësimin të kurrikulës	3.3 Përbajtjet dhe aktivitetet mësimore janë në funksion të qasjes së integruar	4.3 Praktikat e zhvillimit profesional të mësimdhënësve janë në funksion të mësimdhënies së integruar	5.3 Arritshmëria dhe progresi i nxënësve në zotërimin e rezultateve të përcaktuara për fushat kurrikulare plotëson pritshmërinë e vendosur me KB
AUTONOMIA DHE FLEKSIBILITETI	1.4 Prioritetet e zhvillimit të shkollës pasqyrojnë vizionin e saj, nevojat e nxënësve dhe rezultatet e vetëvlerësimit	2.4 Shkolla ka praktika të konsoliduara të përfshirjes së gjithë komunitetit shkollor në përmirësimin dhe mirëmbajtjen e mjedisit fizik	3.4 Autonomia për planifikimin e kurrikulës me zgjedhje shfrytëzohet në mënyrë efektive	4.4 Shkolla shfrytëzon në mënyrë efektive resurset e saj për aktivitetet e ZhPM	5.4 Nxënësit janë të angazhuar në aktivitete ekstra-kurrikulare
PËRGJEGJËSIA DHE LLOGARIDHËNIA	1.5 Udhëheqja e shkollës udhëheq dhe monitoron zbatimin e PZhSh dhe politikave arsimore	2.5 Shkolla ofron një mjedis të sigurt dhe mundësues për realizim të të nxënësve efektiv	3.5 Shkolla është e angazhuar për përmirësimin e praktikave të mësimdhënies dhe të nxënësve	4.5 Shkolla mbikëqyrë ndikimin e ZhPM në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies	5.5 Nxënësit janë të angazhuar në menaxhimin e përparimit vetjak

Shtojca 2: Treguesit për vlerësimin e performancës, pyetjet e orientuese dhe burimet e mundshme të të dhënave

MENAXHIMI DHE QEVERISJA		
1.1 Organet e qeverisjes janë funksionale dhe efektive në përfaqësimin e interesave të komunitetit të shkollës		
Treguesit e performancës së shkollës	Pyetjet orientuese për vlerësimin e performancës së shkollës në raport me secilin tregues	Disa burime të mundshme të të dhënave
1.1.1 Vlerësimet e brendshme të shkollës janë realizuar me pjesëmarrjen e gjithë komunitetit shkollor .	1.1.1 A kanë nxënësit dhe prindërit mundësi të përshtatshme pjesëmarrjeje në vetëvlerësimin e shkollës, planifikimin dhe zbatimin e planit zhvillimor? Cilat janë format kryesore të përfshirjes së prindërve dhe nxënësve në vetëvlerësimin e fundit të realizuar nga shkolla? Po në përpilimin e planit të fundit zhvillimor? Sa është niveli i pjesëmarrjes së nxënësve dhe prindërve në këto procese? A janë pasqyruar në vetëvlerësimin e shkollës interesat e kategorive të ndryshme të nxënësve? Si është arritur deri te identifikimi i këtyre interesave?	Raporti i vetëvlerësimit. PZhSh-Planet e përmirësimit. Evidencat e procesit të vetëvlerësimit. Rezultatet e anketave të realizuara me mesimdhënës, përfaqësues të nxënësve dhe prindërve në organet qeverisëse dhe me personelin tjetër të shkollës.
1.1.2 Nxënësit, mesimdhënësit dhe prindërit janë në dijeni për vizionin dhe misionin e shkollës si dhe për prioritetet e PZhSh-së .	1.1.2 A janë organet përfaqësuese të nxënësve dhe të prindërve në dijeni për vizionin, misionin dhe prioritetet e shkollës? A janë në dijeni për rolin e tyre në përmbushjen e vizionit dhe misionit të shkollës?	Vendimet e shkollës për themelimin e organeve qeverisëse.
1.1.3 Organet e qeverisjes së shkollës i kanë definuar përgjegjësitë e tyre në zbatimin e PZhSh-së .	1.1.3 Cilat janë përgjegjësitë e organeve të qeverisjes në zbatimin e PZhSh? Ku janë definuar këto përgjegjësi? Kush e monitoron përmbushjen e këtyre obligimeve? Çfarë performance kanë treguar në përmbushjen e këtyre obligimeve?	Rregulloret e punës së organeve qeverisëse. Procesverbalet e takimeve të këtyre organeve.
1.1.4 Organet e qeverisjes së shkollës janë funksionale dhe përmbushin obligimet e tyre në zbatimin e PZhSh-së.	1.1.4 A kanë organet e qeverisjes së shkollës përshkrim të qartë të detyrave dhe ndarje të qartë të përgjegjësisë? A takohen në intervale kohore të rregullta? Cili ka qenë niveli i pjesëmarrjes në takimet e realizuara gjatë vitit të fundit? Cilat çështje janë	Raportet e punës së organeve qeverisëse. Rregullorja e shkollës për përfshirjen e nxënësve në proceset vendimmarrëse të shkollës.

<p>1.1.5 Nxënësit kanë mundësi të përshtatshme për të shprehur qëndrimet e tyre.</p> <p>1.1.6 Nxënësit janë të përfaqësuar nga organet e përfaqësimit të nxënësve në shkollë sepse qëndrimet e tyre merren parasysh në proceset vendimmarrëse të shkollës.</p> <p>1.1.7 Prindërit ndjehen të përfshirë dhe të përfaqësuar nga organet e përfaqësimit të prindërve .</p> <p>1.1.8 Prindërit janë të informuar me të gjitha zhvillimet e rëndësishme në shkollë.</p> <p>1.1.9 Prindërit kanë mundësi të përshtatshme për të shprehur qëndrimet e tyre të cilat shqyrtohen në proceset vendimmarrëse të shkollës.</p> <p>1.1.10 Personeli mësimor ndihet i përfaqësuar dhe i vlerësuar në proceset vendimmarrëse të shkollës.</p> <p>1.1.11 Personeli tjetër shkollor ndihet i përfaqësuar dhe qëndrimet e tyre për çështjet që i preokupojnë merren parasysh.</p>	<p>trajtuar në dy takimet e fundit? Sa janë treguar efektive në përmbushjen e përgjegjësive të tyre?</p> <p>1.1.5 Cilat janë format e konsultimit me nxënës? Çfarë mundësish kanë nxënësit për të shprehur qëndrimet e tyre?</p> <p>1.1.6 A ndihen nxënësit të përfaqësuar nga organet e tyre përfaqësuese? Si funksionojnë këto organe? A janë paraparë forma të konsultimit të përfaqësuesve të nxënësve me nxënësit të cilët i përfaqësojnë? Cilat janë këto forma të komunikimit/konsultimit? A janë të evidentuara ato?</p> <p>1.1.7 A ndihen prindërit të përfaqësuar nga organet e tyre përfaqësuese? Si funksionojnë këto organe? A janë paraparë forma të konsultimit të përfaqësuesve të prindërve me prindërit të cilët i përfaqësojnë? Cilat janë këto forma të komunikimit/konsultimit? A janë të evidentuara ato?</p> <p>1.1.8 Sa janë prindërit të informuar me zhvillimet e rëndësishme në shkollë? A janë përfaqësuesit e tyre në dijeni për gjetjet kryesore të vetëvlerësimit të fundit dhe prioritetet vjetore të shkollës?</p> <p>1.1.9 Cilat janë format e konsultimit me prindër? Çfarë mundësish kanë prindërit për të shprehur qëndrimet e tyre? Sa merren parasysh shqetësimet dhe qëndrimet e tyre?</p> <p>1.1.10 A ndihen mësimdhënësit pjesë e rëndësishme e proceseve vendim-marrëse?</p> <p>1.1.11 A ndihet personeli tjetër shkollor pjesë e rëndësishme e proceseve vendim-marrëse?</p>	<p>Rregullorja e shkollës për konsultim me prindër.</p> <p>Pyetësorë/ intervista me mësimdhënësit.</p>
---	--	--

1.2 Shkolla ka në fokus të orientimit strategjik zhvillimin e kompetencave të nxënësve		
Treguesit e performancës së shkollës	Pyetjet orientuese për vlerësimin e performancës së shkollës në raport me secilin tregues	Disa burime të mundshme të të dhënave
1.2.1 Shkolla ka ndërtuar një sistem efektiv të administrimit të rezultateve të arritshmërisë së nxënësve në zotërimin e kompetencave në fund të shkallëve kurrikulare.	1.2.1 A është administrimi i rezultateve të arritshmërisë pjesë e detyrave të organeve profesionale të shkollës? Si analizohen rezultatet e arritshmërisë së nxënësve në zotërimin e kompetencave kryesore në fund të shkallës kurrikulare? A identifikohen, në këtë rast, faktorët që kanë penguar arritshmërinë e nxënësve? A identifikohen, në këtë rast, masat e nevojshme për adresimin e këtyre faktorëve?	Përshkrimi i detyrave të organeve profesionale të shkollës . Raporti i analizës së rezultateve të arritshmërisë së nxënësve në fund të shkallëve kurrikulare. Raporti i vetëvlerësimit të shkollës.
1.2.2 Vlerësimi i arritshmërisë së nxënësve në zotërimin e kompetencave në fund të shkallëve kurrikulare administrohet në mënyrë efektive dhe bazohet në evidenca.	1.2.2 Kush i realizon këto analiza? Mbi çka bazohen ato? A përputhet situata e evidentuar, në këto analiza, me raportin e vetëvlerësimit (Fusha e cilësisë: Performanca e nxënësve)?	Plani Zhvillimor i Shkollës. Plani vjetor i veprimit.
1.2.3 Analiza e rezultateve të arritshmërisë së nxënësve në zotërimin e kompetencave kryesore shfrytëzohet për identifikimin e faktorëve që pengojnë arritshmërinë e nxënësve dhe planifikimin e masave për evitimin e tyre.	1.2.3 A e ka shfrytëzuar shkolla këtë analizë me rastin e planifikimit zhvillimor dhe planifikimit vjetor? Cilët janë faktorët kryesor që e pengojnë arritshmërinë e nxënësve sipas gjetjeve të vetëvlerësimit? A janë identifikuar faktorët e njëjtë edhe nga organet profesionale të mandatuara për administrimin e rezultateve të arritshmërisë?	
1.2.4 Prioritetet e shkollës (në PZhSH apo në dokumente tjera strategjike të shkollës, siç është plani vjetor i veprimit) përfshijnë masat për evitimin e faktorëve që pengojnë arritshmërinë e nxënësve .	1.2.4 Çfarë masash ka planifikuar shkolla për evitimin e faktorëve që pengojnë arritshmërinë e nxënësve? A janë adekuate masat e planifikuara në nivel të shkollës për përmirësimin e arritshmërisë së nxënësve?	

1.3 Organet profesionale janë funksionale dhe efektive në jetësimin e mësimit të integruar		
Treguesit e performancës së shkollës	Pyetjet orientuese për vlerësimin e performancës së shkollës në raport me secilin tregues	Disa burime të mundshme të të dhënave
1.3.1 Organet profesionale funksionojnë si menaxhment i mesëm në shkollë dhe kanë procedura të qarta të veprimit.	1.3.1 A kanë organet profesionale të shkollës përshkrim të qartë të detyrave dhe ndarje të qartë të përgjegjësi? A takohen në intervale të rregullta? Cili ka qenë niveli i pjesëmarrjes në takimet e realizuara gjatë vitit të fundit? Cilat çështje janë trajtuar në dy takimet e fundit? Kush e vlerëson performancën e tyre? A ekzistojnë evidenca të këtyre vlerësimeve? ¹⁵	Vendimet për themelimin e organeve profesionale të shkollës. Rregulloret e punës së organeve profesionale. Procesverbalet e takimeve të organeve profesionale .
1.3.2 Planet dhe programet mësimore në nivel të shkallëve kurrikulare mundësojnë planifikimin dhe realizimin e proceseve të integruara mësimore.	1.3.2 A janë planifikuar procese të integruara mësimore në kuadër të lëndëve që mbulojnë një fushë kurrikulare? A janë të gjitha lëndët në funksion të arritjes së rezultateve të të nxënit për fushën kurrikulare së cilës i takojnë?	Raportet e analizave të proceseve mësimore dhe të rezultateve të nxënësve të realizuara nga organet profesionale.
1.3.3 Planet javore të proceseve mësimore mundësojnë integrim kurrikular.	1.3.3 A mundësojnë planet javore ndërlidhjen e mësimit me jetën? A janë të ndërlidhura temat kryesore që trajtohen në kuadër të të gjitha lëndëve si pjesë e një tërësie tematike?	Planet dhe programet mësimore në nivel të shkallëve kurrikulare.
1.3.4 Organet profesionale të shkollës përgatisin raporte të rregullta për përparimin e bërë në zbatimin e planeve dhe programeve mësimore, sfidat dhe masat për tejkalimin e tyre.	1.3.4 Në çfarë intervalesh kohore përgatiten këto raporte? A janë në dispozicion? A janë përmbajtjesore apo formale/sipërfaqësore? A i kanë identifikuar si duhet sfidat kryesore? Sa janë aplikuar masat e rekomanduara për tejkalimin e sfidave? Nëse nuk janë aplikuar, pse ka ndodhur kjo gjë? Nëse janë aplikuar, sa kanë qenë efektive në përmirësimin e planifikimit dhe realizimit të mësimit të integruar?	Planet javore të proceseve mësimore . Raportet e vlerësimit të punës së organeve profesionale nga udhëheqja e shkollës.

¹⁵ Në lidhje me rolin e organeve profesionale shih më tepër në: Udhëzues për udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në shkollë, fq. 81-82, IPK, 2016, Prishtinë dhe Udhëzimin Administrativ të MASHT për Aktivet profesionale në institucionet arsimore të arsimit parauniversitar

<p>1.3.5 Analiza e arritshmërisë së rezultateve të përcaktuara për fushat kurrikulare shfrytëzohet nga organet profesionale për përmirësimin e praktikave të realizimit të proceseve mësimore.</p>	<p>1.3.5 A vlerësohet cilësia e mësimdhënies dhe format e përkrahjes së nxënësve nga perspektiva e efikasitetit në ngritjen e arritshmërisë së nxënësve në zotërimin e rezultateve të përcaktuara për fushat kurrikulare? Nga kush bëhen këto vlerësime? A janë të evidentuara ato?</p>	
<p>1.3.6 Shkolla ka ndërtuar një sistem efektiv të administrimit të rezultateve të arritshmërisë së nxënësve në zotërimin e rezultateve të përcaktuara për fushat kurrikulare.</p>	<p>1.3.6 Si analizohen rezultatet e arritshmërisë së nxënësve në zotërimin e rezultateve të përcaktuara për fushat kurrikulare? A identifikohen, me këtë rast, faktorët që kanë penguar arritshmërinë e nxënësve dhe masat e nevojshme për adresimin e këtyre faktorëve? Kush i bën këto analiza? Mbi çka bazohen ato? A ka shkolla evidenca të këtyre analizave?</p>	

1.4 Prioritetet e zhvillimit të shkollës, nevojat e nxënësve dhe rezultatet e vetëvlerësimit		
Treguesit e performancës së shkollës	Pyetjet orientuese për vlerësimin e performancës së shkollës në raport me secilin tregues	Disa burime të mundshme të të dhënave
1.4.1 Vizioni dhe misioni i shkollës janë koherentë me pritshmëritë e nxënësve, prindërve dhe mësimdhënësve .	1.4.1 A janë vizioni dhe misioni i shkollës koherentë me pritshmëritë e nxënësve, prindërve dhe mësimdhënësve?	PZhSH Raportet e vetëvlerësimit. Anketat e realizuara me nxënës, prindër dhe mësimdhënës në lidhje me preokupimet dhe pritshmëritë e tyre nga shkolla.
1.4.2 Vlerësimi i brendshëm i performancës së shkollës bëhet në baza vjetore dhe sipas procedurave të përcaktuara nga MASHT.	1.4.2 Cilat janë përvojat paraprake të shkollës me procesin e vetëvlerësimit?	
1.4.3 Prioritetet e PZhSh pasqyrojnë vizionin dhe misionin e shkollës .	1.4.3 A i ka përcaktuar shkolla prioritetet adekuate të zhvillimit, duke pasur parasysh vizionin dhe misionin e saj, si dhe nevojat e nxënësve të identifikuar në raportet e vetëvlerësimit?	
1.4.4 Raporti i vlerësimit të brendshëm të shkollës pasqyron gjendjen reale në shkollë.	1.4.4 A i pasqyron raporti i vetëvlerësimit sfidat dhe arritjet reale të shkollës?	
1.4.5 Prioritetet e PZhSh paqyrojnë masat e nevojshme për adresimin e sfidave të identifikuar gjatë vetëvlerësimit të shkollës dhe vlerësimit të jashtëm të saj.	1.4.5 A përmban PZhSh masa adekuate për adresimin e sfidave dhe avancimin e përparësive të identifikuar gjatë vetëvlerësimit?	
1.4.6 Prioritetet e planeve vjetore të shkollës adresojnë pikat më të ndjeshme të identifikuar gjatë procesit të vetëvlerësimit dhe rezultateve .	1.4.6 Si janë renditur masat vjetore të intervenimit? A i reflektojnë ato masa pikat më të ndjeshme që kërkojnë intervenim të menjëhershëm? Sa janë zbatuar ato masa gjatë periudhës e cila është objekt i këtij vlerësimi?	

1.5 Menaxhmenti i shkollës udhëheq dhe monitoron zbatimin e PZhSh dhe politikave arsimore

Treguesit e performancës së shkollës	Pyetjet orientuese për vlerësimin e performancës së shkollës në raport me secilin tregues	Disa burime të mundshme të të dhënave
<p>1.5.1 Shkolla ka formuar ekipe pune për realizimin e prioriteteve zhvillimore të shkollës dhe jetësimit të politikave arsimore.</p>	<p>1.5.1 Çfarë ekipesh ka formuar shkolla për realizimin e prioriteteve të saj? Si është organizuar shkolla për koordinimin e zbatimit të prioriteteve zhvillimore dhe politikave arsimore? Çfarë masash ka ndërmarrë shkolla për të avancuar bashkëpunimin me prindër dhe komunitetin në funksion të zbatimit të planit zhvillimor?</p>	<p>Përshkrimi i detyrave të organeve qeverisëse, profesionale dhe ekipeve të tjera të themeluara në nivel shkollë për koordinimin, monitorimin dhe raportimin mbi proceset e zbatimit të PZhSH dhe planeve vjetore.</p>
<p>1.5.2 Procesi i realizimit të PZhSh mbikqyret dhe përkrahët vazhdimisht nga organet kompetente të shkollës.</p>	<p>1.5.2 A është operativ plani vjetor i shkollës? A i ka të definuar qartë afatet kohore dhe përgjegjësitë për zbatimin e masave të planifikuara? A janë pasqyruar këto përgjegjësi në përshkrimin e detyrave të organeve qeverisëse dhe profesionale të shkollës?</p>	<p>Raportet e monitorimit dhe raportimit mbi zbatimin e PZhSH dhe planeve vjetore të shkollës.</p>
<p>1.5.3 Shkolla posedon raporte të rregullta mbi realizimin e PZhSh dhe planit vjetor të zhvillimit të shkollës.</p>	<p>1.5.3 A ka vendosur shkolla procedura të qarta të raportimit dhe llogaridhënies? A i posedon shkolla raportet mbi realizimin e PZhSh dhe planit vjetor të veprimit?</p>	<p>Masat e ndërmarra për adresimin e sfidave dhe zbatimin e rekomandimeve të ofruara në raportet e zbatimit.</p>
<p>1.5.4 Përgjegjësia dhe llogaridhënia në nivel shkollë është e qartë për të gjitha nivelet e udhëheqjes së shkollës .</p>	<p>1.5.4 A janë të definuar qartë përgjegjësitë dhe hierarkia e raportimit për të gjitha nivelet e udhëheqjes? A janë të gjithë përfaqësuesit e këtyre organeve në dijeni për këto përgjegjësi?</p>	<p>Evidencat e formave të aplikuara të bashkëpunimit me prindër dhe komunitet në funksion të zbatimit të prioriteteve të shkollës.</p>

KULTURA DHE MJEDISI SHKOLLOR		
2.1 Objekti dhe hapësirat tjera të shkollës janë të qasshme, të sigurta, të shëndetshme dhe miqësore		
Treguesit e performancës së shkollës	Pyetjet orientuese për vlerësimin e performancës së shkollës në raport me secilin tregues	Disa burime të mundshme të të dhënave
2.1.1 Objekti i shkollës, përfshirë oborrin dhe hapësirat rreth shkollës, ku, të gjithë nxënësve, u mundësohet qasje dhe lëvizje e lirë.	2.1.1 A ekzistojnë barriera që pengojnë qasjen dhe lëvizjen fizike në objektin e shkollës dhe hapësirat përreth? Nëse po, cilat janë ato?	Vëzhgimi dhe evidentimi i gjendjes fizike të shkollës.
2.1.2 Objekti i shkollës, përfshirë oborrin dhe hapësirat rreth shkollës që janë të sigurta, të këndshme dhe stimuluese për nxënie, aktivitete sociale dhe rekreative.	2.1.2 A janë të sigurta hapësirat brenda dhe jashtë objektit të shkollës? A janë ato të këndshme dhe stimuluese për nxënie? A mundësojnë aktivitete sociale dhe rekreative?	Vëzhgimi i atmosferës dhe kulturës së përgjithshme të sjelljes në shkollës.
2.1.3 Nxënësit janë të mbrojtur nga lëndimet fizike, nga dhuna dhe presioni emocional	2.1.3 A janë nxënësit të ekspozuar ndaj ndonjë rreziku?	Intervista dhe anketa me nxënës, prindër dhe me personelin shkollor.
2.1.4 Mjedisi fizik i shkollës (ndriçimi, ajrosja, temperatura, lagështia e ajrit, uji i pijshëm, oborri) është i favorshëm për zhvillimin e fëmijëve.	2.1.4 A është mjedisi fizik i shkollës i favorshëm për zhvillimin e fëmijëve (ndriçimi, ajrosja, kushtet higjienike, temperatura, lagështia e ajrit, uji i pijshëm, oborri)?	
2.1.5 Higjiena, në të gjitha hapësirat e shkollës (brenda dhe jashtë objektit), është në nivel të lartë.	2.1.5 Si e vlerësoni higjienën në shkollë? A ka ndonjë aspekt problematik? Si është adresuar ai nga shkolla?	
2.1.6 Në kuadër të shkollës, të gjithë nxënësit, prindërit dhe personeli shkollor, trajtohen me dinjitet dhe respekt.	2.1.6 A siguron kultura e shkollës që të gjithë fëmijët, prindërit dhe personeli shkollor, të trajtohen në mënyrë të barabartë, të drejtë, me dinjitet dhe respekt? Nëse po, si e ka arritur këtë? Çka e karakterizon kulturën e shkollës? Çfarë mendojnë vet nxënësit për këtë? Po prindërit? Po mësimmësuesit?	
2.1.7 Mjedisi i shkollës është mbështetës dhe miqësor, ku të gjithë nxënësit dhe prindërit ndihen të mirëpritur, të përkrahur dhe pjesë e institucionit.	2.1.7 A ndihen nxënësit dhe prindërit të mirëpritur, të përkrahur dhe pjesë e institucionit? A ndihet personeli shkollor i vlerësuar, i konsultuar dhe i përkrahur për të planifikuar dhe për të realizuar arsim cilësor?	

2.2 Shkolla siguron për të gjithë nxënësit mundësi të barabarta për zotërimin e kompetencave		
Treguesit e performancës së shkollës	Pyetjet orientuese për vlerësimin e performancës së shkollës në raport me secilin tregues	Disa burime të mundshme të të dhënave
2.2.1 Niveli i pritshmërisë së shkollës për zotërimin e kompetencave, për arritjet akademike dhe për realizimin individual të secilit nxënës është i lartë.	2.2.1 Si e vlerëson shkolla kapacitetin e nxënësve dhe kapacitetin e shkollës për të përkrahur të gjithë nxënësit në zotërimin e kompetencave dhe realizimin individual të secilit nxënës? Cili është qëndrimi i organeve udhëheqëse të shkollës? Po i mësimdhënësve?	Procedurat e shkollës për identifikimin e barrierave të cilat pengojnë qasjen, vijueshmërinë dhe arritjet e nxënësve në shkollë. Raportet e barrierave të identifikuara dhe masat e planifikuara për eliminimin e tyre.
2.2.2 Ekipi për Parandalim dhe Reagim ndaj mosregjistrimit dhe braktisjes (EPMRB) është funksional dhe ka procedura të qarta për identifikimin e barrierave të cilat mund të pengojnë qasjen, vijueshmërinë dhe arritjet e nxënësve në shkollë.	2.2.2 A i kushton shkolla vëmendje identifikimit të faktorëve që ndikojnë në procesin e të nxënësve dhe zhvillimin e kompetencave kryesore? Cilët janë faktorët kryesorë që pengojnë qasjen, vijueshmërinë dhe arritjet e nxënësve në shkollë? A janë evidentuar ata nga shkolla?	Evidencat mbi praktikën e bashkëpunimit me ofrues tjerë të shërbimeve (Qendra për punë sociale, Qendra të mjekësisë familjare, OJQ, biznese etj.).
2.2.3 Shkolla ka krijuar rrjete të bashkëpunimit me ofrues të jashtëm të shërbimeve sociale, shëndetësore e ekonomike për eliminimin e barrierave, të cilat mund të pengojnë qasjen, vijueshmërinë dhe arritjet e nxënësve në shkollë.	2.2.3 Cilat janë praktikën e bashkëpunimit me ofrues tjerë të shërbimeve për fuqizim të fëmijëve dhe familjeve të tyre? Cilat forma të përkrahjes aplikohen në shkollë për të siguruar mundësi të barabarta për zhvillim të kompetencave kryesore?	Masat e aplikuar për eliminimin e barrierave dhe evidencat për efektivitetin e tyre.
2.2.4 Shkolla mundëson realizimin e potencialit të secilit nxënës përmes aktiviteteve të ndryshme jashtëkurrikulare që kanë për qëllim avancimin e prirjeve individuale të nxënësve.	2.2.4 Cilat forma të përkrahjes aplikohen për avancimin e prirjeve të nxënësve në fusha të ndryshme me qëllim të realizimit të plotë të potencialit të tyre? Sa është interesimi i nxënësve për pjesëmarrje në këto aktivitete? Cili është mendimi i nxënësve për to?	Programi i mësimin plotësues, shtues dhe jashtë-kurrikular që aplikohet në shkollë dhe evidencat e realizimit.
2.2.5 Mësimdhënësit përpilojnë dhe zbatojnë PIA-në për nxënësit me nevoja të veçanta në arsim.	2.2.5 A është efektive qasja e shkollës për përkrahjen e nxënësve me nevoja të veçanta duke përfshirë integrimin e tyre në jetën sociale të shkollës? Çfarë masash aplikon shkolla? A janë ato efektive?	
2.2.6 Niveli i braktisjes së shkollës nga nxënësit është shumë i ulët.	2.2.6 Cili është niveli dhe trendet e braktisjes së shkollës? Çfarë masash aplikon shkolla për të parandaluar braktisjen?	

2.3 Mjedisi dhe kultura e punës së shkollës janë në funksion të nxënies së integruar dhe jetësimit të kurrikulës		
Treguesit e performancës së shkollës	Pyetjet orientuese për vlerësimin e performancës së shkollës në raport me secilin tregues	Disa burime të mundshme të të dhënave
2.3.1 Burimet (njerëzore dhe financiare) dhe mjetet mësimore janë të mjaftueshme për të mundësuar realizimin e procesit mësimor sipas kërkesave të përcaktuara me kurrikulat bërthamë.	3.3.1 A janë të mjaftueshme burimet mësimore për të realizuar proceset mësimore sipas kërkesave të përcaktuara me kurrikulat bërthamë?	Vëzhgimi i hapësirave të shkollës . Procedurat e shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve dhe mjeteve mësimore.
2.3.2 Pajisjet dhe mjetet mësimore janë të organizuara mirë, të qasshme dhe shfrytëzohen në mënyrë efektive për të përmbushur nevojat e nxënësve.	2.3.2 Si janë organizuar dhe çfarë rregullash ka vendosur shkolla për shfrytëzimin e pajisjeve dhe mjeteve mësimore?	Inventari i pajisjeve dhe mjeteve mësimore . Evidencat për kontributin e nxënësve në përmirësimin e mjedisit shkollor dhe pasurimin e inventarit të mjeteve mësimore.
2.3.3 Nxënësit shfrytëzojnë në mënyrë të pavarur dhe të përgjegjshme burimet të cilat i disponon shkolla.	2.3.3 A kanë nxënësit qasje të pavarur në burimet e të nxënit me të cilat posedon shkolla? A janë ata të përgjegjshëm në shfrytëzimin e kësaj të drejte? A kontribuojnë nxënësit për përmirësimin e mjedisit shkollor?	Analiza e planeve të orëve mësimore dhe vëzhgimi i proceseve mësimore.
2.3.4 Mësimdhënia dhe nxënia pasurohen me shfrytëzimin e vazhdueshëm të TIK-ut, mjedisit përreth dhe të burimeve të tjera, jashtë shkollës.	2.3.4 Sa dhe si shfrytëzohet TIK? Sa dhe si shfrytëzohet mjedisi dhe burimet tjera jashtë shkolle?	Raportet e vëzhgimeve dhe përkrahjes kolegjiale.
2.3.5 Klasat, laboratorët, hapësirat përcjellëse dhe pajisjet janë në funksion të plotë të realizimit të mësimimit të integruar.	2.3.5 A janë klasat, laboratorët, hapësirat përcjellëse dhe pajisjet në funksion të plotë të realizimit të mësimimit të integruar?	Vetëreflektimet e mësimdhënësve.
2.3.6 Seancat e vëzhgimit, (vet) reflektimit dhe ndihmës së ndërsjellë praktikohen nga mësimdhënësit në shkollë, me qëllim përmirësimin e mësimdhënies.	2.3.6 Çfarë formash të reflektimit dhe përkrahjes së ndërsjellë ndërmjet mësimdhënësve aplikohen në shkollë? A promovon udhëheqja e shkollës komunikimin dhe bashkëpunimin, frymën ekipore dhe ngritjen e moralit të mësimdhënësve?	Raportet e organeve profesionale të shkollës.

2.4 Shkolla ka praktika të konsoliduara të përfshirjes së gjithë komunitetit shkollor në përmirësimin dhe mirëmbajtjen e mjedisit fizik		
Treguesit e performancës së shkollës	Pyetjet orientuese për vlerësimin e performancës së shkollës në raport me secilin tregues	Disa burime të mundshme të të dhënave
2.4.1 Shkolla ka praktikë të konsoliduar të bashkëpunimit me prindër dhe komunitet në funksion të përmirësimit dhe mirëmbajtjes së mjedisit fizik.	2.4.1 Cilat janë praktikat e bashkëpunimit me prindër dhe komunitet në funksion të përmirësimit dhe mirëmbajtjes së mjedisit fizik?	Evidencat për kontributin e prindërve në përmirësimin e mjedisit shkollor dhe pasurimin e inventarit të mjeteve mësimore.
2.4.2 Prindërit dhe komuniteti janë të përfshirë në përmirësimin dhe mirëmbajtjen e mjedisit të shkollës.	2.4.2 Sa është niveli i përfshirjes së prindërve në përmirësimin dhe mirëmbajtjen e mjedisit shkollor? Po i komunitetit? Si i mirëmban shkolla këto partneritete? Çfarë formash aplikon shkolla për tu shprehur mirënjohje prindërve dhe komunitetit? A i shfrytëzon bashkëpunimet e konsoliduara për të mobilizuar partnerë të tjerë?	Evidencat për kontributin e komunitetit në përmirësimin e mjedisit shkollor dhe pasurimin e inventarit të mjeteve mësimore. Evidencat e mirënjohjeve që shkolla u ka ndarë kontribuuesve.
2.4.3 Në kuadër të proceseve mësimore dhe aktiviteteve ekstrakurrikulare, nxënësit inkurajohen dhe përkrahen që të kontribuojnë në përmirësimin e mjedisit shkollor dhe pasurimin e materialeve mësimore.	2.4.3 A kontribuojnë nxënësit në përmirësimin e mjedisit shkollor dhe pasurimin e materialeve mësimore? Cilat janë format e përfshirjes së tyre?	Uebfaqja e shkollës apo forma të tjera të publikimit të këtyre kontributeve.
2.4.4 Mësimdhënësit bashkëpunojnë ngushtë mes veti dhe me nxënësit për krijimin e materialeve mësimore, për sigurimin dhe shkëmbimin e tyre.	2.4.4 Cilat janë format e kontributit të mësimdhënësve?	

2.5 Shkolla ofron një mjedis të sigurt dhe mundësues për realizim të të nxënit efektiv		
Treguesit e performancës së shkollës	Pyetjet orientuese për vlerësimin e performancës së shkollës në raport me secilin tregues	Disa burime të mundshme të të dhënave
2.5.1 Shkolla ka mekanizma për t'u marrë me rastet e aksidenteve dhe fatkeqësive elementare (apo me situata të tjera të rrezikut të përgjithshëm).	2.5.1 Çfarë mekanizmash ka vendosur shkolla për t'u marrë me rastet e aksidenteve dhe fatkeqësive elementare (apo me situata të tjera të rrezikut të përgjithshëm)? A janë funksional? A janë efektiv në përmbushjen e obligimeve të tyre? Kush e monitoron punën e tyre?	Mekanizmat e shkollës për t'u marrë me situatat e rrezikut Plani për adresimin e vështirësive të funksionimit (realizimin e proceseve mësimore, mësimin plotësues-shtues, aktiviteteve jashtë kurrikulare, takimeve me prindër, punës ekipore të mësimdhënësve, etj.)
2.5.2 Shkolla ka vendosur një mekanizëm efektiv të menaxhimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm të mjedisit fizik shkollor.	2.5.2 A i ka siguruar shkolla burimet dhe pajisjet elementare për të mundësuar realizimin e funksioneve themelore të shkollës? A praktikon shkolla inventarizimin e pajisjeve? A ka vendosur shkolla procedura të qarta të përgjegjësisë për dëmet? A ka shkolla një plan të përkohshëm për adresimin e vështirësive të funksionimit?	Mekanizmat e zhvillimit të vazhdueshëm të mjedisit fizik shkollor.
2.5.3 Shkolla ka standarde të kujdesit dhe sigurimit të mirëqenies së fëmijëve, të hartuara në bashkëpunim me organet shkollore, me prindër dhe komunitet.	2.5.3 A ka hartuar shkolla standarde të kujdesit dhe sigurimit të mirëqenies së nxënësve? Si identifikohen aspektet e sigurisë? Si adresohen ato?	Rregullat e mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit të resurseve materiale të shkollës.
2.5.4 Gjithë personeli i shkollës është në dijeni për të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara me standardet e sjelljes, kujdesit dhe mirëqenies.	2.5.4 A ekziston një ndarje e qartë e përgjegjësive për sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve? A është i gjithë personeli shkollor në dijeni për këto përgjegjësi?	Standardet e kujdesit dhe mirëqenies së fëmijëve.
2.5.5 Pakoja e rregulloreve të shkollës është në funksion të parandalimit të abuzimeve, ekseseve dhe shkeljeve të të gjitha llojeve.	2.5.5 Çfarë përmban pakoja e rregulloreve të shkollës për sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve? A ka ndonjë aspekt të rëndësishëm të sigurisë dhe mirëqenies që nuk është trajtuar? Sa aplikohen ato? A janë treguar efektive në rritjen e sigurisë dhe mirëqenies së nxënësve në shkollë? A ka të dhëna (dëshmi) në lidhje me këtë?	Anketat me personelin e shkollës në lidhje me qartësinë e të drejtave dhe detyrimeve të tyre. Kodi etik i shkollës.

MËSIMDHËNIA DHE NXËNIA

3.1 Shkolla siguron përfshirjen e nxënësve dhe prindërve në procesin mësimor

Treguesit e performancës së shkollës	Pyetjet orientuese për vlerësimin e performancës së shkollës në raport me secilin tregues	Disa burime të mundshme të të dhënave
3.1.1 Në shkollë është vendosur një sistem funksional për përfshirjen e prindërve dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm në procesin mësimor.	3.1.1 Cilat janë format e përfshirjes së prindërve si pjesëmarrës aktiv dhe partner në realizimin e procesit mësimor? Cilat janë format e përfshirjes së partnerëve të tjerë, jashtë shkolle?	Vëzhgimi i procesit mësimor Portfoliot e nxënësve.
3.1.2 Metodatat e mësimdhënies dhe vlerësimit mundësojnë pjesëmarrjen aktive të nxënësve në procesin mësimor.	3.1.2 Cili është niveli i pjesëmarrjes aktive të nxënësve në procesin mësimor? Çfarë zgjidhjesh aplikohen për t'i trajtuar dallimet e nxënësve në procesin e nxënies dhe nevojat e tyre të veçanta? Sa është procesi mësimor atraktiv për nxënësit? Sa i reflektojnë interesimet dhe përvojat e tyre paraprake? Si përjetohen ato nga nxënësit?	Fokus grupet dhe intervistat me nxënës dhe prindër. Pyetësorë me nxënës.
3.1.3 Nxënësit janë pjesëmarrës aktiv në përpjekjet për avancimin e procesit mësimor	3.1.3 Cilat janë format e përfshirjes së nxënësve në avancimin e procesit mësimor?	Planet dhe programet mësimore . Programet vjetore.
3.1.4 Prindërit janë të informuar për arritshmërinë, zhvillimin dhe progresin e fëmijëve.	3.1.4 A janë prindërit të informuar për arritshmërinë, zhvillimin dhe progresin e fëmijëve? Çfarë formash të komunikimit shfrytëzohen për këtë qëllim?	Planet javore të procesit mësimor.
3.1.5 Prindërit janë të përfshirë në procesin e planifikimit dhe të jetësimit të kurrikulës me bazë në shkollë	3.1.5 Cilat janë format e përfshirjes së prindërve në avancimin e procesit mësimor?	Planet e orëve mësimore
	3.1.6 A janë nxënësit të vetëdijshëm për rëndësinë e aktiviteteve mësimore në të cilat marrin pjesë? A ka kuptim procesi mësimor?	

<p>3.1.6 Nxënësit janë të informuar dhe të vetëdijshëm për arsyeshmërinë e çdo aktiviteti mësimor në të cilin marrin pjesë dhe për përgjegjësinë e tyre për përmirësim dhe sukses</p>	<p>3.1.7 A shfrytëzohet vlerësimi për inkurajimin dhe motivimin e nxënësve për nxënie?</p>	
<p>3.1.7 Vlerësimi për të nxënë bëhet me metoda adekuate për inkurajimin dhe motivimin e vazhdueshëm të nxënësve në nxënie</p>	<p>3.1.8 A është vlerësimi i të nxënësve transparent dhe korrekt? A janë nxënësit në dijeni për notat e tyre? A pajtohen me vlerësimin e bërë nga mësuesit? Cilat janë shqetësimet e tyre në lidhje me këtë proces?</p>	
<p>3.1.8 Vlerësimi i të nxënësve (notimi) është transparent, korrekt dhe ndihmues për nxënësit</p>	<p>3.1.9 A pasqyrohen preokupimet dhe pritshmëria e nxënësve dhe prindërve në planin e aktiveve profesionale për përmirësimin e procesit mësimor? Si identifikohen këto shqetësime dhe pritshmëri?</p>	
<p>3.1.9 Preokupimet e nxënësve, prindërve dhe kuadrit mësimor lidhur me procesin mësimor janë të pasqyruara në planin e shkollës për përmirësimin e procesit mësimor</p>		

3.2 Procesi mësimor mundëson mbështetje të diferencuar të nxënësve për zotërimin e kompetencave dhe zhvillimin e potencialit të tyre		
Treguesit e performancës së shkollës	Pyetjet orientuese për vlerësimin e performancës së shkollës në raport me secilin tregues	Disa burime të mundshme të të dhënave
3.2.1 Procesi i mësimdhënies respekton dhe bazohet në diversitetin e nxënësve.	3.2.1 Cili është niveli i motivimit të nxënësve për mësim? Si i perceptojnë nxënësit përmbajtjen dhe procesin mësimor?	Vëzhgimi i proceseve mësimore Portfoliot e nxënësve Anketat me nxënës
3.2.2 Mësimdhënësit ofrojnë për secilin nxënës përkrahje të individualizuar drejt progresit në përvetësimin e kompetencave kryesore dhe realizimit të potencialit të tyre.	3.2.2 A aplikohet qasje e individualizuar e përkrahjes në zotërimin e kompetencave kryesore? Si identifikohen dhe fuqizohen prirjet individuale të nxënësve gjatë procesit mësimor?	Raportet e analizave të rezultateve të vlerësimit sumativ të nxënësve (në fund të çdo teme, në fund të çdo gjysmë vjetori dhe në fund të shkallëve kurrikulare)
3.2.3 Mësimdhënësit bashkëveprojnë në kuadër të organeve profesionale në procesin e planifikimit dhe zbatimit të qasjeve dhe metodave adekuate për zhvillimin e kompetencave kryesore.	3.2.3 Çfarë qasje shfrytëzohet nga mësimdhënësit për zhvillimin e kompetencave kryesore?	Raportet mbi realizimin e planeve dhe programeve mësimore
3.2.4 Metodrat dhe strategjitë e mësimdhënies e të nxënies që praktikohen në klasë dhe jashtë saj janë në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve.	3.2.4 A janë identifikuar masat e nevojshme për zhvillimin e kompetencave kryesore në kuadër të planeve dhe programeve për shkallë kurrikulare? Kush e monitoron zbatimin e tyre?	Planet dhe programet për shkallë kurrikulare – me fokus zhvillimin e kompetencave kryesore ¹⁶
3.2.5 Rezultatet e vlerësimit dhe informatat kthyesë të nxënësve shfrytëzohen për të planifikuar dhe përshtatur procesin mësimor në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve.	3.2.5 A shfrytëzohet vlerësimi formativ për përkrahjen e nxënësve në planifikimin e të nxënies së tyre? A shfrytëzohet për identifikimin dhe adresimin e nevojave të ndryshme të nxënësve me rastin e planifikimit të procesit mësimor?	

¹⁶ Për më tepër në lidhje me këtë shih: Udhëzues për udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në shkollë, fq. 51, IPK, 2016, Prishtinë

3.3 Përmbajtjet dhe procesi mësimor në funksion të qasjes së integruar		
Treguesit e performancës së shkollës	Pyetjet orientuese për vlerësimin e performancës së shkollës në raport me secilin tregues	Disa burime të mundshme të të dhënave
3.3.1 Planet dhe programet mësimore përgatiten në mënyrë sistematike, me kohë dhe janë në funksion të mësimin të integruar.	3.3.1 Sa janë planet dhe programet e mësimdhënësve për procesin mësimor në funksion të qasjes dhe mësimdhënies së integruar?	Vëzhgimi i procesit mësimor
3.3.2 Përmbajtjet dhe proceset mësimore, në kuadër të lëndëve që mbulojnë një fushë kurrikulare, janë në funksion të arritjes së rezultateve të përcaktuara për atë fushë kurrikulare.	3.3.2 A janë përmbajtja dhe procesi mësimor në funksion të arritjes së rezultateve të nxënies për fushën përkatëse kurrikulare? A është efektiv menaxhimi i klasës? Sa ia arrijnë mësimdhënësit që të krijojnë një atmosferë inkurajuese dhe nxitëse për të nxënë?	Planet dhe programet mësimore
3.3.3 Procesi mësimor integron dhe reflekton lidhjet dhe ndërvarësitë me jetën reale. Situatat reale dhe mjetet rrethore janë pjesë integrale e procesit mësimor.	3.3.3 A i kushtohet vëmendja e duhur ndërlidhjes së përmbajtjeve mësimore me situatat dhe problemet reale? Sa dhe si shfrytëzohet mjedisi dhe burimet tjera jashtë shkolle në procesin mësimor?	Programet vjetore Planet javore të procesit mësimor Planet e orëve mësimore
3.3.4 Përmbajtja dhe procesi mësimor reflektojnë preokupimet e nxënësve, të mjedisit në të cilin vepron shkolla dhe të shoqërisë.	3.3.4 A janë përmbajtjet mësimore të inspiruara nga situata reale dhe aktuale jetësore? A i reflektojnë ato preokupimet aktuale të nxënësve, si dhe shqetësimet e shoqërisë?	Raportet e analizave të rezultateve të vlerësimit sumativ të nxënësve (në fund të çdo teme, në fund të çdo gjysmë vjetori dhe në fund të shkollëve kurrikulare) ¹⁷
3.3.5 Përmbajtjet mësimore reflektojnë zhvillimet në sferën shoqërore, ekonomike, kulturore e shkencore.	3.3.5 A janë përmbajtjet mësimore në hap me zhvillimet në sferën shoqërore, ekonomike, kulturore e shkencore?	Raportet mbi realizimin e planeve dhe programeve mësimore
3.3.6 Procesi mësimor mundëson zbatimin e dijes dhe shfrytëzimin e shkathtësive, qëndrimeve e vlerave të caktuara në kontekst të zgjidhjes së problemeve praktike dhe reale të jetës.	3.3.6 Sa i kushtohet vëmendje zhvillimit të shkathtësive të mendimit kritik gjatë procesit mësimor? Sa i kushtohet vëmendje zbatimit të dijes dhe shkathtësive, të qëndrimeve dhe vlerave të kultivuara në kontekst të zgjidhjes së problemeve praktike dhe reale të jetës së përditshme?	

¹⁷ Për më tepër në lidhje me këtë shih: Udhëzues për udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në shkolla, fq.73-74, IPK, 2016, Prishtinë

3.4 Autonomia për planifikimin e kurrikulës me zgjedhje shfrytëzohet në mënyrë efektive		
Treguesit e performancës së shkollës	Pyetjet orientuese për vlerësimin e performancës së shkollës në raport me secilin tregues	Disa burime të mundshme të të dhënave
3.4.1 Organet profesionale dhe qeverisëse të shkollës kanë praktika të konsoliduara për planifikimin dhe jetësimin e kurrikulës me zgjedhje	3.4.1 A është shpërndarja e fondit të orëve për lëndë / vit shkollor në funksion të organizimit të aktiviteteve mësimore që janë sfiduese dhe atraktive për nxënësit? A janë respektuar kriteret e Kornizës së Kurrikulës për zgjedhjen e përmbajtjeve dhe burimeve mësimore?	Evidencat mbi ecurinë e planifikimit të procesit mësimor në nivel të shkallëve kurrikulare, javore dhe vjetore Planet dhe programet mësimore Programet vjetore
3.4.2 Kurrikula me zgjedhje është në funksion të përmbushjes së nevojave të veçanta të nxënësve, që dalin nga rrethanat dhe veçoritë specifike të komunitetit, në të cilin vepron shkolla.	3.4.2 Për çka e shfrytëzon shkolla kurrikulën me zgjedhje? A mundëson ajo adresimin e sfidave të veçanta të nxënësve të shkollës përkatëse për zotërimin e kompetencave kryesore? ¹⁸	Planet javore të procesit mësimor Planet e orëve mësimore Evidencat mbi ecurinë e planifikimit të kurrikulës me zgjedhje
3.4.3 Shkolla organizon rregullisht rishikimin dhe freskimin e kurrikulës me zgjedhje duke u bazuar në rezultatet e vlerësimit të arritshmërisë së kompetencave në fund të shkallëve kurrikulare	3.4.3 A shfrytëzohet vlerësimi përmbyllës për rishikimin dhe freskimin e kurrikulës me zgjedhje? Si është dokumentuar ky proces?	Planet dhe programet e kurrikulës me zgjedhje Raportet e realizimit të planeve dhe programeve të kurrikulës me zgjedhje
3.4.4 Udhëheqja e shkollës shfrytëzon autonominë që shkolla ka në dispozicion për të përcaktuar detyrat e personelit mësimor duke u bazuar në përparësitë e secilit mësimdhënës.	3.4.4 A janë përcaktuar detyrat e personelit mësimor konform aftësive/ekspertizës së tyre, duke siguruar shfrytëzimin optimal të resurseve njerëzore? Si është evidentuar ky proces?	

¹⁸ Për më tepër në lidhje me këtë shih: Udhëzues për udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në shkolla, fq.60-61, IPK, 2016, Prishtinë

3.5 Shkolla është e angazhuar vazhdimisht për përmirësimin e praktikave të mësimdhënies dhe të të nxënit		
Treguesit e performancës së shkollës	Pyetjet orientuese për vlerësimin e performancës së shkollës në raport me secilin tregues	Disa burime të mundshme të të dhënave
3.5.1 Shkolla ka procedura të raportimit mbi cilësinë dhe efektivitetin e përvojave të mësimdhënies dhe nxënies në funksion të zbatimit të kërkesave të kurrikulës shtetërore dhe përmbushjes së misionit të saj.	3.5.1 A është shkolla e përkushtuar për përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve mësimore? Çfarë mekanizmesh ka vendosur për monitorimin dhe raportimin e cilësisë dhe efektivitetit të procesit mësimor?	Raportet e punës së shërbimeve profesionale Procesverbalet e takimeve të organeve profesionale (aktiveve dhe këshillave të klasave)
3.5.2 Mësimdhënësit angazhohen aktivisht në përmirësimin e praktikave të mësimdhënies e të të nxënit.	3.5.2 Cilat janë praktikat e mësimdhënësve për përmirësimin e mësimdhënies? Mbi çka bazohen kur reflektojnë për performancën vetjake? Si e planifikojnë përmirësimin? A i kanë të evidentuara këto procese?	Fokus grup me mësimdhënës Planet vjetore të shkollës
